



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AVOKATI I POPULLIT

**PËR NDJEKJEN, ANALIZIMIN DHE EVIDENTIMIN E SHKAQEVE
QË KANË NDIKUAR NË RRIJTJEN E KËRKESAVE PËR AZIL TË
SHTETASVE SHQIPTARË NË SHTETET ANËTARE TË ZONËS
SHENGEN**

Prill 2014

Institucioni i Avokatit të Popullit

Blvd.: “Zhan D’Ark” nr. 2, Tirana, Shqipëri, Tel./Fax: +355 (4) 2380 313

Web: www.avokatipopullit.gov.al

PËRMBAJTJE

Hyrje	3
1. Institucionet, mekanizmat dhe baza ligjore e BE për azilin.	5
2. Liberalizimi i vizave për hapësirën Shengen.....	7
3. Çështja e azilkërkuesve nga Ballkani Perëndimor në BE.....	9
4. Azilkërkuesit shqiptarë në shtetet e zonës Shengen dhe veprimtaria e Avokatit të Popullit.	10
4.1. Minoriteti rom në Shqipëri.....	13
4.2. Komuniteti LGBT në Shqipëri.....	16
4.3. Fenomeni i gjakmarrjes në Shqipëri.....	20
4.4. Dhuna ndaj grave.	27
4.5. Fëmijët e pashoqëruar nga prindërit.....	34
4.6. Shërbimi shëndetësor.	44

Hyrje

Me termin “azil” do të kuptojmë një formë mbrojtje të dhënë nga një shtet në territorin e tij, bazuar në parimin e *non-refoulement* (mos-kthimit) dhe në të drejtat e njohura ndërkombëtare dhe kombëtare të refugjatëve. Azili i garantohet personit, i cili e ka të pamundur të kërkojë mbrojtje në vendin e tij/saj, në të cilin është shtetas ose rezident, për shkak të frikës nga persekutimi për arsye të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisimit në një grup social ose një opinionin politik, etj.¹

Ndërsa termin “azilkërkues” i referohet personit i cili kërkon mbrojtje në një vend tjetër nga ai i origjinës, për shkak të persekutimit ose kanosjes së një dëmi serioz dhe është në pritje të vendimit mbi aplikimin për statusin e refugjatit në përputhje me instrumentet relevante ndërkombëtare dhe kombëtare. Në rast të një vendimi negativ ndaj kërkesës për azil, personi duhet të ikë nga vendi ku ka kërkuar azil dhe mund të dëbohet, siç mund të dëbohet çdo person jo-shtetas në një situatë që nuk është konform rregullave dhe ligjeve të vendit përkatës. Përjashtim përbëjnë rastet kur është dhënë leje-qëndrim për arsye humanitare dhe arsye të tjera të lidhura me këtë çështje.²

Sipas “Konventës mbi Statusin e Refugjatit” të vitit 1951 dhe protokollit të saj zbatues të vitit 1967, palë të së cilave janë 146 shtete dhe e ratifikuar nga Shqipëria më 18 gusht 1992, “*Refugjat*” është *çdo person, i cili për shkak të frikës së bazuar nga përndjekja për shkak të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar social apo politik, gjendet jashtë vendit të origjinës dhe nuk ka mundësi apo për shkak të një frike të tillë, nuk ka dëshirë të kërkojë mbrojtjen e atij vendi; ose për shkak se nuk ka shtetësi dhe duke qenë jashtë vendit të rezidencës së zakonshme si rezultat i ngjarjeve të tilla, apo për shkak të frikës, nuk ka dëshirë të kthehet.*³

Shpesh nocioni “azilkërkues” ngatërrohet me atë të “refugjatit”: azilkërkuesi është individi i cili pohon që është refugjat por që kërkesa e tij ende nuk është vlerësuar përfundimisht nga autoritetet përkatëse dhe derisa kërkesa në fjalë të trajtohet, azilkërkuesi ka të drejtë të mos

¹ Glossary on Migration, 2nd Edition, IOM - International Organization for Migration, faqe 11.

² *Ibid*, faqe 12.

³ <http://www.unhcr.org>

kthehet në vendin e origjinës. Sapo merr statusin e refugjatit apo ndonjë status tjetër si p.sh. mbrojtje humanitare, azilkërkuesi quhet refugjat apo person që ka përfituar azil.

Nëse autoritetet kombëtare, nëpërmjet procedurave të caktuara, gjykojnë që individi nuk mund të përfitojë statusin e refugjatit apo ndonjë formë tjetër të mbrojtjes ndërkombëtare, atëherë mund të kthejnë individin në vendin e tij.

Sipas të dhënave të UNHCR (Komisioneri i Lartë i OKB-së për Refugjatët), numri global i refugjatëve sipas mandatit të UNHCR-së është vlerësuar në 11.1 milion.⁴ Pikërisht si pasojë e përndjekjes për arsye kombëtare, fetare, raciale, ideologjike etj., miliona njerëz janë detyruar të braktisin dhe t'i lenë trojet e veta.

Nga ana tjetër, neni 2 i Protokollit nr. 4 të Konventës e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, përcakton lirinë e lëvizjes, ku ndër të tjera sanksionohet që çdo person është i lirë të largohet nga çdo vend, duke përfshirë të tijin. E drejta për tu larguar nga vendi, qoftë ky vendi i nënshtetësisë apo i qëndrimit, është një parakusht i domosdoshëm për ushtrimin e një mori të drejtash të tjera, përfshirë këtu të drejtën për mbrojtje ndërkombëtare nga tortura, trajtimi/dënim çnjerëzor ose degradues. Në përcaktimin e kufizimeve për tu larguar nga vendi, shteti duhet të ketë në vëmendje konventën në fjalë dhe vendimet Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.⁵

Lidhur me situatën e krijuar pas liberalizimit të vizave në Shqipëri, ku një numër i madh shtetasish shqiptarë kanë paraqitur kërkesat e tyre për azil në disa nga vendet e BE-së dhe të zonës Shengen, institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me mandatin e tij kushtetues për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve shqiptarë, e sheh si të nevojshëm trajtimin në kohë të kësaj çështje, në mënyrë që të mos rrezikohet liberalizimi i vizave për Shqipërinë, të parandalohet abuzimi me kërkesat për azil dhe mbi të gjitha të adresohen problematikat e lidhura me grupet, komunitetet dhe minoritetet, pjesëtarët e të cilëve janë më shumë të përfshirë nga ky fenomen.

Raporti “Për ndjekjen, analizimin dhe evidentimin e shkaqeve që kanë ndikuan në rritjen e kërkesave për azil të shtetasve shqiptarë në shtetet anëtare të zonës Shengen”, trajton

⁴ E dhëna më lart i referohet Raportit të UNHCR “Mid-Year Trends 2013”.

⁵ Për një analizë më të detajuar të së drejtës për tu larguar nga vendi, referohuni studimit “Right to leave the country”, Këshilli i Evropës, nëntor 2013.

problematikat e hasura nga shtetet e zonës Shengen me azilkërkuesit nga Shqipëria, duke konstatuar dhe analizuar të dhënat si dhe shkaqet e paraqitura për azil nga shtetasit shqiptarë. Raporti thekson në mënyrë të veçantë gjendjen e krijuar në hapësirën Shengen nga shtimi i numrit të azilkërkueseve nga Shqipëria por edhe nga Ballkani Perëndimor gjatë viteve të fundit dhe gjithashtu përqendrohet në problematikat dhe rekomandimet përkatëse për grupe sociale dhe etnike të tilla si minoriteti rom, viktimat e gjakmarrjes, komuniteti LGBT etj., të cilët rezultojnë se gjenerojnë numrin më të madh të azilkërkuesve shqiptarë. Në hartimin e këtij raporti janë përdorur të dhëna nga raportet e ndryshme nga organet e specializuara të BE për azilkërkuesit, përkatësisht Agjencia Evropiane për Mbështetjen e Azilkërkuesve (EASO), të dhënat nga përfaqësitë diplomatike të shteteve të hapësirës Shengen në Shqipëri, si dhe raportet e veçanta të institucionit të Avokatit të Popullit. Raporti përmban një sërë rekomandimesh të ndara sipas kategorive përkatëse, të cilat trajtojnë dhe adresojnë të gjitha problematikat e konstatuara përgjatë hartimit të këtij dokumenti.

1. Institucionet, mekanizmat dhe baza ligjore e BE për azilin.

Çështja komplekse e azilit, ka bërë që komuniteti ndërkombëtar të angazhohet prej shumë vitesh në krijimin e mekanizmave juridikë e institucionalë, për përballjen me këtë sfidë globale.

Një numër i madh organizmash ndërkombëtare e fokusojnë aktivitetin e tyre tek e drejta e azilit dhe aspekte të saj juridike, sociale, politike e kulturore. Ndër institucionet zyrtare më të rëndësishme në nivel Evropian për sa i përket trajtimit të çështjeve të azilkërkuesve mund të përmendim:

- Agjencinë Evropiane për Mbështetjen e Azilkërkuesve (EASO)⁶ - EASO është një agjenci e Bashkimit Evropian e themeluar me Rregulloren nr. 439/2010 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Kjo agjenci luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit (CEAS)⁷. EASO u themelua me qëllimin e thellimit të bashkëpunimit praktik mes vendeve anëtare për çështjet e azilkërkuesve si dhe për monitorimin e plotësisht të detyrave ndërkombëtare në lidhje

⁶ European Asylum Support Office.

⁷ Common European Asylum System.

me azilkërkuesit nga ana e shteteve të Bashkimit Evropian. Një funksion tjetër i rëndësishëm i EASO është dhe se ajo shërben si një qendër ekspertize e çështjeve që kanë lidhje me azilin si dhe ofron mbështetje për vendet e BE-së të cilat mund të kenë probleme në këtë fushë.

- Agjenci tjetër e rëndësishme që merret me çështjet e emigracionit dhe të azilkërkuesve është edhe Agjencia Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të BE (FRONTEX). Kjo agjenci ka për detyrë të marrë masa për ruajtjen dhe kontrollin e kufijve të jashtëm të BE, por dhe në rastin e azilkërkuesve duhet thënë se është një ndër portat e para të takimit mes BE dhe azilkërkuesve të cilët në shumicën e rasteve kanë pikën e kalimit nga kufijtë e jashtëm të BE. FRONTEX nxjerr raporte me të dhëna të detajuara mbi statistikën e azilkërkuesve.

Në bazë të përmbushjes së detyrimeve të tyre në lidhje me problematikat e azilit, vendet e Bashkimit Evropian kanë hartuar një sërë rregulloresh dhe marrëveshesh që kanë të bëjnë me këtë çështje. Këto hapa të përbashkët kanë sjellë krijimin e Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit (CEAS). Kjo e fundit është një politikë madhore e BE në lidhje me çështjet e azilit që ka në fokusin e saj krijimin e një sistemi të drejtë dhe afatgjatë të trajtimit të këtij problemi. Rregulla të reja janë krijuar, duke vendosur standarde të larta dhe një bashkëpunim sa më të qëndrueshëm mes vendeve të BE në mënyrë që të sigurohet një trajtim sa më i barabartë dhe një sistem i hapur dhe i drejtë për të gjithë azilkërkuesit. Ndër pikat më të rëndësishme të *acquis communautaire* në këtë drejtim, mund të përmendim:

- Direktiva mbi kualifikimin⁸, e rishikuar - kjo direktivë sqaron kriteret për dhënien e mbrojtjes ndërkombëtare. Një rregullore e tillë bën të mundur dhënien e vendimeve më të bazuar në lidhje me azilkërkuesit si dhe përmirëson integrimin e përfituesve të mbrojtjes ndërkombëtare.
- Rregullorja EUODAC⁹, e rishikuar - Kjo direktivë mundëson akses të plotë të bazuar në ligj në informacionet lidhur me azilkërkuesit si p.sh: shenjat e gishtërinjve për të zbuluar krime të ndryshme ose raste terrorizmi.
- Direktiva për kushtet e pranimit, e rishikuar¹⁰ - Siguron që të ketë kushte njerëzore pritjeje për azilkërkuesit në BE (p.sh. strehim), si dhe të respektohen të drejtat

⁸ Direktiva 2011/95/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE.

⁹ Database i të dhënave të shenjave të gishtërinjve të azilkërkuesve në Evropë.

¹⁰ Direktiva 2013/33/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE.

themelore të njeriut për azilkërkuesit. Direktiva gjithashtu siguron që ndalimi të aplikohet vetëm si një masë e fundit e mundshme.

- Direktiva për procedurat e azilit e rishikuar¹¹ - Ka për qëllim sigurimin një vendimmarrje sa më të shpejtë dhe sa më të drejtë në lidhje me kërkesat për azil. Azilkërkuesit me nevoja të veçanta do të marrin mbështetjen e nevojshme për të shpjeguar gjendjen e tyre dhe do të ketë mbrojtje më të madhe për të miturit e pashoqëruar si dhe për viktimat e torturës.
- Rregullorja e Dublinit, e rishikuar¹² - Rregullorja e Dublinit e rishikuar ka hyrë në fuqi në 1 janar 2014. Kjo rregullore siguron mbrojtjen e azilkërkuesve gjatë procesit të përcaktimit të shtetit përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës së tyre si dhe sqaron rregullat që kanë të bëjnë me marrëdhëniet mes shteteve në lidhje me këtë çështje. Krijohet një rrjet paralajmërimi i cili sinjalizon problemet e reja në sistemin e pritjes së azilkërkuesve në çdo vend të BE si dhe merret me trajtimin e shkaqeve të këtyre problemeve në mënyrë që të parandalojë kriza të mundshme në të ardhmen. Ndër ndryshimet kryesore që solli rishikimi i Rregullores së Dublinit ishin dhe parashikimi i një asistencë ligjore falas për azilkërkuesit, mundësinë e apelimit të vendimit të transferimit për azilkërkuesin, një mekanizëm vëzhgimi, paralajmërimi dhe menaxhimi të problemeve dhe krizave të mundshme, një limitim strikt të periudhës së ndalimit të azilkërkuesve si dhe më shumë transparencë ligjore në lidhje me procedurat mes shteteve Anëtare, për sa i përket çështjes së azilit. E gjithë procedura e parashikuar nga Rregullorja e Dublinit nuk mund të zgjasë më shumë se 11 muaj për të shqyrtuar kërkesën dhe jo më shumë se 9 muaj për të kryer kthimin e azilkërkuesit në vendin e origjinës.

2. Liberalizimi i vizave për hapësirën Shengen.

Më 16 dhjetor 2010, Ministrat e Brendshëm të 27 vendeve anëtare të Bashkimit Evropian miratuan unanimisht vendimin që Shqipërisë dhe Bosnje Hercegovinës t'i hiqen vizat për të udhëtuar në të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, përveç Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës, duke amenduar rregulloren nr. 539/2001 "Lista e vendeve të treta, shtetasit e të cilëve duhet të posedojnë viza kur kalojnë kufijtë e jashtëm dhe shtetasit që

¹¹ Direktiva 2013/32/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE.

¹² Rregullorja 604/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE.

përrjashtohen nga kjo kërkesë”. Qytetarët shqiptarë mund të udhëtojnë pa viza edhe në vende të tjera të zonës Shengen, që nuk janë anëtare të BE, të tilla si: Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia e Zvicra. Në bazë të këtij vendimi qytetarët e Shqipërisë do të gëzojnë të drejtën për lëvizje të lirë në zonën Shengen si dhe të drejtë qëndrimi deri në tre muaj, për qëllime turistike, por pa patur mundësinë që të jetojnë dhe punojnë në këto vende.

Vendimi në fjalë u shoqërua me një deklaratë, me anë të së cilës përmendet mundësia për rivendosjen e vizave, në rast se ndonjë vend anëtar e sheh këtë të arsyeshme, gjithnjë nëse konstatohen abuzime.

Vihet re që lëvizja e lirë e shtetasve shqiptarë në hapësirën Shengen, përveç se ka shtuar lëvizjen e lirë të shtetasve shqiptarë në hapësirën Shengen, ka shkaktuar gjithashtu raste të shumta të kërkesave për të qëndruar në këto vende si dhe rritjen e kërkesave për azil, që në shumë raste janë të paargumentuara dhe rrjedhimisht refuzohen nga organet përkatëse. Duhet theksuar që Kodi Kufitar i Hapësirës Shengen¹³ vendos një sërë kushtesh për lirinë e lëvizjes të personave që udhëtojnë nga vendet e treta drejt hapësirës Shengen, përfshirë dhe Shqipërinë, të cilat janë:

- a) *Zotërimi i një dokumenti të vlefshëm udhëtimi ose dokumente që autorizojnë ata të kalojnë kufirin;*
- b) *Posedimi të një vize të vlefshme, në qoftë se kërkohet në pajtim me Rregulloren e Këshillit (EC) nr. 539/2001 e 15 mars 2001, duke renditur vendet e treta shtetasit e të cilëve duhet të posedojnë vizë kur kalojnë kufijtë e jashtëm dhe shtetasit e të cilëve janë të përjashtuar nga kjo kërkesë, përveç rasteve kur ata mbajnë një leje qëndrimi të vlefshme;*
- c) *Justifikimi i qëllimit dhe kushteve të qëndrimit, dhe posedimi i mjeteve të mjaftueshme të jetesës, si për kohëzgjatjen e qëndrimit, ashtu dhe për kthimin në vendin e tyre të origjinës ose për tranzitin në një vend të tretë, në të cilin ata janë të sigurt do të pranohen, ose nëse janë në gjendje për të blerë mjete të tilla në mënyrë të ligjshme;*
- d) *Ata nuk janë persona për të cilët është lëshuar një alarm SIS për qëllime të refuzimit të hyrjes;*
- e) *Ata nuk konsiderohen të jenë një kërcënim për politikën publike, sigurinë e brendshme, shëndetin publik ose marrëdhëniet ndërkombëtare të ndonjë prej shteteve*

¹³ Rregullorja 562/2006 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE, datë 15.03.2006 “Mbi rregullat që përcaktojnë lëvizjen e personave në kufijtë Shengen”.

anëtare, sidomos kur në bazën e të dhënave kombëtare të shteteve anëtare nuk rezulton asnjë alarm, që të jetë është lëshuar për qëllimin e refuzimit të hyrjes në të njëjtat baza.¹⁴

Në lidhje me azilin, Kodi Kufitar i Hapësirës Shengen përcakton se: *“Shtetasi i vendeve të treta që nuk i përmbush të gjitha kushtet e hyrjen në hapësirën Shengen të përcaktuara në Nenin 5 (1) (si më lart) dhe që nuk i përket kategorive të personave të përmendur në Nenin 5 (4), do t'i refuzohet hyrja në territoret e shteteve anëtare. Kjo nuk cenon zbatimin e dispozitave të veçanta në lidhje me të drejtën e azilit dhe të mbrojtjes ndërkombëtare apo dhënien e vizave me qëndrim të gjatë.”¹⁵*

Më 12 shtator 2013, Parlamenti Evropian mbështeti iniciativën e anëtarëve të BE, për miratimin e një klauzole mbrojtëse, e cila i mundëson shtetet anëtare të hapësirës Shengen për të riaktivizuar regjimin e vizave për vendet e treta të cilat paraqesin një rrezik potencial për emigracion. Amendimi i rregullores (EC) nr. 539/2001, *“Vendet e treta shtetasit e të cilëve duhet të posedojnë viza kur kalojnë kufijtë e jashtëm dhe shtetasit tek të cilët nuk aplikohet ky detyrim”* përcakton se, që nga data 9 janar 2014, në qoftë se një vend anëtar i BE përballet me një rritje të papritur të emigrantësh të parregullt ose azilkërkuesish, ai do të duhet të njoftojë Komisionin Evropian. Komisioni më tej duhet të propozojë pezullimin e udhëtimit pa viza për vendin ose vendet e origjinës për një periudhë fillestare prej gjashtë muajsh. Nëse situata nuk përmirësohet brenda kësaj kohe, udhëtimi i lirë me këto vende mund të pezullohet për një kohë të papërcaktuar.

3. Çështja e azilkërkuesve nga Ballkani Perëndimor në BE.

Kërkesat për azil nga qytetarët e Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia) janë rritur ndjeshëm viteve të fundit duke tejkaluar ndjeshëm kërkesat për azil të vendeve të tjera. Në total numri i

¹⁴ Neni 5 i Rregullores 562/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE, datë 15.03.2006 “Mbi rregullat që përcaktojnë lëvizjen e personave në kufijtë e hapësirës Shengen”.

¹⁵ Neni 13 i Rregullores 562/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE.

kërkesave për azil nga vendet e Ballkanit perëndimor për 2012 ka qenë 53,000 dhe në 96% të rasteve janë refuzuar.¹⁶

Sipas të dhënave të EASO: “Numri i kërkesave për azil ka qenë i ndryshueshëm me kalimin e kohës (duke treguar një prirje të përgjithshme rritëse) dhe sezonal (gjithnjë kështu në vitet e fundit), duke shënuar rritje para periudhës së dimrit. Sezonaliteti është veçanërisht i theksuar në rastin e kërkesave nga Serbia dhe Maqedonia dhe kjo mund të lidhet me faktorë të veçantë, që prekin komunitetin Rom atje, pasi që anëtarët e këtij komuniteti përbëjnë shumicën e azilkërkuesve nga këto vende”.¹⁷

Shteti i parë i rajonit për numrin e azilkërkuesve është Serbia (38% e kërkesave), e ndjekur nga Kosova (29%), Maqedonia (14%), Shqipëria (10%) dhe Mali i Zi (2%)¹⁸. Përgjithësisht shumica e azilkërkuesve nga Ballkani Perëndimor, janë romë nga Serbia dhe Maqedonia, si dhe shqiptarë nga Shqipëria dhe Kosova. Rajonet kryesore të prejardhjes së azilkërkuesve nga Ballkani Perëndimor, janë Kosova, Shqipëria e Veriut, Serbia Jugore dhe Maqedonia e Veriut.

Edhe pse kërkesat për azil nga shtetasit e Ballkanit perëndimor në shumicën dërrmuese të rasteve refuzohen shkalla e refuzimit varion sipas vendit të origjinës. Kështu kërkesat për azil nga shtetasit shqiptarë kanë shkallën e aprovimit më të lartë krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, ndërsa shtetasit maqedonas kanë shkallën më të ulët.

4. Azilkërkuesit shqiptarë në shtetet e zonës Shengen dhe veprimtaria e Avokatit të Popullit.

Sipas të dhënave nga organet e specializuara të BE, numri i kërkesave për azil nga Shqipëria për 2011 ka qenë 3,060 ndërsa për vitin 2012 numri është rritur në 7,465 kërkesa.¹⁹ Vihet re një rritje e kërkesave për azil nga shtetasit shqiptarë në BE, përkatësisht në vitin 2011

¹⁶ Asylum applicants from the Western Balkans comparative analysis of trends, push-pull factors and responses, EASO, 2013, faqe 8.

¹⁷ *Ibid*, faqe 21.

¹⁸ *Ibid*, faqe 21.

¹⁹ Këto të dhëna i referohen Raportit Vjetor të EASO për vitin 2012.

kërkesat për azil nga shtetasit shqiptarë kanë përbërë 1% të kërkesave në total të bëra në BE, ndërsa në vitin 2012, kjo shifër është rritur në 2% të kërkesave të bëra në BE.²⁰

Ndërkohë po të bëjmë një krahasim me vitin 2009, rezulton që numri i kërkesave për azil nga shtetasit shqiptarë në BE ka qenë 1,965 kërkesa, ndërsa numri i kërkesave gjatë vitit 2010 ka qenë 1,820 kërkesa për azil.²¹

Ndërsa, raportohet se gjatë vitit 2013, numri i kërkesave për azil nga shtetasit shqiptarë ka qenë 10,599.²²

Më poshtë paraqiten të dhënat ndër vite në lidhje me kërkesat për azil të shtetasve shqiptarë në vendet e Bashkimit Evropian²³:

	2009	2010	2011	2012	2013
Numri i kërkesave për azil në BE	1,965	1,820	3,060	7,465	10,599
Diferenca në % nga viti në vit		-7.4%	+68.1%	+144%	+42%

Nisur nga rritja e kërkesave për azil në vendet e BE, si dhe duke pasur në vëmendje gjendjen humanitare të shtetasve shqiptarë që kërkojnë azil dhe të shtetasve të tjerë shqiptarë të cilëve ju rrezikohet heqja e regjimit të lirë të vizave, institucioni i Avokatit të Popullit ka ngritur një grup pune për ndjekjen, analizimin dhe evidentimin e shkaqeve që kanë ndikuar në rritjen e kërkesave për azil të shtetasve shqiptarë në shtetet anëtare të zonës Shengen.

Grupi i punës për evidentimin e shkaqeve të rritjes së kërkesave për azil të shtetasve shqiptarë në vendet e zonës Shengen mbajti kontakte dhe shkëmbeu informacione me disa prej ambasadave të vendeve kryesore të zonës Shengen, të cilat rezultonin se kishin numrin më të lartë të kërkesave për azil nga shtetasit shqiptarë.

Krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, në muajt e parë pas heqjes së regjimit të vizave, kërkesat për azil nga vendi ynë ishin të pakta. Por në vijim vihet re një rritje e numrit

²⁰ Raportit Vjetor të EASO për vitin 2012, faqe 95.

²¹ UNHCR, “Asylum Levels and Trends in Industrialised Countries”, 2011, faqe 24; UNHCR, “Asylum Levels and Trends in Industrialised Countries”, 2010, faqe 19.

²² UNHCR, “Asylum Levels and Trends in Industrialised Countries”, 2013, faqe 27.

²³ Këto të dhëna dhe të dhënat në vijim i referohen statistikave për BE-27, si dhe BE-28 pas anëtarësimit të Kroacisë në BE.

të kërkesave për azil. Në këtë kuadër, në bazë të një vendimi të marrë me datë 16 dhjetor 2013 nga ana e *Conseil d'Etat* (Gjykata më e lartë administrative në Francë), Shqipëria shtohet në listën e vendeve të sigurta të origjinës²⁴. Shtetasit e vendeve të përfshira në këtë listë të cilët aplikojnë për azil, do të jenë subjekt i procedurave të përshpejtuara, pasi kërkesat e tyre janë konsideruar nga Zyra Franceze për Mbrojtjen e Refugjatëve dhe personave pa shtetësi (OFPRA)²⁵ të jenë “abuzive” apo “të pabaza”, bazuar në supozimin se në këto vende nuk ka gjasa të ndodhë persekutim apo keqtrajtim.²⁶ Në bazë të të dhënave të ndara nga Ambasada e Francës në Shqipëri, numri i azilkërkuesve deri në fund të muajit korrik 2013, rezulton të jetë 2,331. Ndërsa ky numër rezulton të jetë rritur në 3,483 kërkesa deri në shtator 2013.²⁷

Gjithashtu, në bazë të të dhënave të ndara nga ana e përfaqësive diplomatike në Shqipëri, rezulton që për vitin 2013, numri i kërkesave është si më poshtë vijon: Austri: 44 kërkesa për azil; Gjermani: 315 kërkesa për azil; Spanjë: 12 kërkesa për azil; Suedi: 464 kërkesa për azil; Zvicër: 54 kërkesa për azil.²⁸

Në analizë të shkaqeve që kanë ndikuar në rritjen e kërkesave për azil të shtetasve shqiptare, rezulton se një ndër motivet kryesorë që paraqesin shtetasit shqiptarë në kërkesën e tyre në momentin e aplikimit për azil është:

- Gjakmarrja;
- Dhunën në familje (kundër grave);
- Diskriminimin (minoriteti rom, komuniteti LGBT);
- Trafikimin e qenieve njerëzore;
- Problemet shëndetësore;
- Arsyet ekonomike; etj.

Konstatojmë se përveç kërkesave për azil, ka rritje të rasteve të të miturve që shkojnë vetëm në këto vende (Francë, Gjermani etj.) dhe kërkojnë mbrojtje nga shërbimet sociale dhe nga

²⁴ Vendimi i datës 16 dhjetor 2013, *Conseil d'Etat*, Gazeta Zyrtare e Francës nr. 0301 e 28 dhjetor 2013, faqe 21652. Koncepti i vendeve të sigurta të origjinës trajtohet nga ligji i datës 10 dhjetor 2003. Për më shumë informacion: <http://www.ofpra.gouv.fr>

²⁵ Office Français de Protection des Réfugiés et Apatrides.

²⁶ Për më shumë informacion: <http://www.ecre.org> dhe <http://www.asylumineurope.org>

²⁷ E dhëna i referohet informacionit të ndarë nga partnerët ndërkombëtarë të Avokatit të Popullit.

²⁸ Të dhënat për vitin 2013 kanë shtrirje kohore deri në muajin qershor-gusht 2013.

drejtësia e këtyre vendeve. Të miturit nuk shprehin ndonjë arsye të veçantë lidhur me kërkesat e tyre, por ata aplikojnë për ndihmë dhe përfitojnë mbrojtje për faktin e vetëm se janë të mitur.

Vlen të theksohet fakti se Policia Kufitare dhe Migracionit (PKM), me qëllim marrjen e masave për të ndaluar çdo tentativë për kalim të kufirit të shtetasve që nuk u lejohet hyrja në BE, përfshirë dhe ata që kanë kërkuar azil, ka evidentuar në bazën e saj të të dhënave të gjithë shtetasit, të cilët kanë shkelur rregullat e qëndrimit në një nga vendet e zonës Schengen dhe që iu është ndaluar hyrja në këtë zonë për një periudhë të caktuar kohe.

Në këto kushte, e gjithë problematika ka të bëjë me mirëqeverisjen dhe funksionimin e shtetit ligjor dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të shtetasve në vend, të sanksionuara në Kushtetutë dhe në ligjet në fuqi.

Në këto fusha kërkohet një ndërhyrje e menjëhershme e qeverisë shqiptare për të mos rrezikuar penalizimin dhe pezullimin e lëvizjes pa viza të shtetasve shqiptare në zonën Shengen.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjykon që problematika në fjalë duhet të ndiqet në vazhdimësi dhe t'i bëhet me dije Kuvendit si dhe institucioneve tjera të administratës publike në Shqipëri, përfshirë këtu Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Shëndetësisë si dhe Ministrinë e Integritimit Evropian.

4.1. Minoriteti rom në Shqipëri.

Sipas të dhënave të marra nga disa prej ambasadave të vendeve anëtare të zonës Shengen, rezulton se disa nga shtetasit shqiptarë që kanë kërkuar azil në këto vende, janë romë dhe se shkak i kërimit të azilit ka qenë diskriminimi për shkak të përkatësisë së tyre etnike. Gjithashtu, nga informacione të ndryshme të marra nga anëtarë të minoritetit rom rezulton që shumë qytetarë romë kanë kërkuar azil ekonomik për shkak të kushteve të vështira ekonomike në të cilat ndodhen.

Avokati i Popullit, si një institucion kushtetues, një ndër prioritetet e punës së tij, ka dhe respektimin e të drejtave të minoritetit Rom. Sipas Raportit të Veçantë “*Për problematikat dhe gjendjen e të drejtave të minoritetit Rom në Shqipëri*”, të hartuar në muajin tetor 2013 nga institucioni i Avokati të Popullit, konstatohet që minoriteti Rom në Shqipëri aktualisht ndeshet me problematika të shumta në fushën e strehimit, regjistrimit në zyrën e gjendjes civile, e ndihmës ekonomike, arsimit si dhe në kushtet e jetesës dhe të infrastrukturës. Romët në Shqipëri, janë në mjaft raste viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe fëmijët romë shpeshherë shfrytëzohen në aktivitetet e lypjes, apo në sektorë të ndryshëm të ekonomisë informale. Minoriteti Rom është komuniteti më i varfër dhe i diskriminuar në Shqipëri dhe kjo ka sjellë që shumë romë të emigrojnë jashtë vendit për një jetë më të mirë.

Niveli i varfërisë së familjeve rome është shumë i lartë. Familjet e varfra dhe shumë të varfra rome përballen me nivele më të larta të përjashtimit social, sepse ato janë më pak në gjendje t’i përballojnë nevojat e jetës së përditshme dhe kanë më pak mundësi të marrin pjesë në proceset që ndikojnë në jetën e tyre, të tilla si punësimi dhe arsimi. Shumë familje rome janë të përjashtuara nga përfitimi i asistencës shtetërore, ose nga marrja e kësaj asistence për aq kohë sa është e nevojshme.

Treguesit socialë për popullsinë rome janë konsideruar më të ulëta se mesatarja kombëtare dhe një pjesë e madhe e minoritetit rom jeton në mes të kushteve të pasigurta, të pambrojtur dhe nën nivelin mesatar të jetesës.²⁹

Sipas anketës social-ekonomike me romët dhe egjiptianët, USAID 2011, rezulton që 30.9% e romëve të grupmoshës 18 deri 40 vjeç, dëshirojnë të migrojnë nga Shqipëria.³⁰ Ky është një tregues mjaft i rëndësishëm, që nënkupton gjithashtu që një numër i konsiderueshëm qytetarësh të këtij minoriteti, janë potencialisht të predispozuar të emigrojnë, ndoshta edhe duke përdorur instrumentin e kërkimit të azilit. Ndaj kjo çështje duhet të adresohet sa më parë të jetë e mundur, në mënyrë që Shqipëria të vijojë të jetë në gjendje për të përmbushur detyrimet e saj në kudër të marrëveshjes për liberalizimin e vizave si dhe në lidhje me angazhimet e ndërmarra në marrëdhëniet dypalëshe me shtetet anëtare të zonës Shengen.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka hartuar një sërë rekomandimesh, që kanë patur si për qëllim përmirësimin e gjendjes së këtij minoriteti etno-gjuhësor në Shqipëri. Rekomandimet e

²⁹ Strategjia Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom”.

³⁰ Ilir Gëdeshi, Juna Miluka, USAID, “Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri”, Tiranë, 29 shkurt 2012.

Avokatit të Popullit, në periudhën 2012-2013 i janë dërguar disa organeve të administratës publike në nivel qendror e vendor dhe lidhen me:

- Përfshirjen më të gjerë në programet e formimit profesional dhe të punësimit, të pjesëtarëve të minoritetit Rom.
- Ndryshimet në bazën normative ligjore për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike, me fokus minoritetin Rom.
- Ndryshimet në legjislacionin ekzistues për strehimin e banorëve në zonat urbane, me fokus minoritetin Rom.
- Marrjen e masave për regjistrimin e pjesëtarëve të minoritetit Rom, në regjistrat e gjendjes civile dhe lehtësimin e procedurave të transferimit të të dhënave të gjendjes civile, në njësitë vendore ku ata kanë vendbanimin aktual, apo edhe në vendbanimin e tyre të ri.
- Lehtësimin e regjistrimit dhe ndjekjes së procesit mësimor nga ana e fëmijëve të minoritetit Rom dhe për marrjen e masave që do të ndikojnë për një akses më të mirë në arsim të këtyre fëmijëve.
- Përmirësimin e kushteve të jetesës në përgjithësi, si dhe në vendbanime konkrete të minoritetit Rom, sikurse godina e ish Repartit Ushtarak, të ndodhur në Zonën e Sharrës, Tiranë.
- Trajtimin me strehim të pjesëtarëve të minoritetit Rom, nga ana e organeve të pushtetit vendor.
- Ndërmarrjen e masave pozitive nga ana e shtetit, për të siguruar barazinë faktike dhe efektive të pjesëtarëve të minoritetit Rom në aksesin që, ata duhet të kenë në sistemin arsimor në vend, duke filluar nga arsimi parashkollor e në vazhdim.
- Realizimin e iniciativës legjislative, për disa përmirësime në nenin 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”, duke përfshirë në këtë nen si shkaqe për diskriminim; kombësinë; qëllimin e shpallur për të diskriminuar; nxitjen për diskriminim dhe ndihmesën dhe inkurajimin e diskriminimit.³¹

Zbatimi i këtyre rekomandime nga autoritetet përkatëse do të ndikonte ndjeshëm në përmirësimin e kushteve të jetesës, si dhe në integrimin e këtij minoriteti etno-gjuhësor në shoqërinë shqiptare dhe për rrjedhojë numri kërkesave për azil në shtetet e zonës Shengen nga anëtarët e këtij komuniteti, do të ulej ndjeshëm.

³¹Avokati i Popullit, Raporti i veçantë “Për problematikat dhe gjendjen e të drejtave të minoritetit rom në Shqipëri”, Tiranë, tetor 2013.

Nga ana tjetër Avokati i Popullit do të vijojë të ndjekë nga afër problematikat e romëve, por duke rritur vëmendjen edhe ndaj pjesëtarëve të këtij komuniteti, të cilët për shkaqe të ndryshme kanë kërkuar azil jashtë vendit, duke ngritur një dialog ndër-institucional edhe me pjesëmarrjen e organizatave rome.

4.2. Komuniteti LGBT në Shqipëri.

Në bazë të kontakteve dhe shkëmbimit të informacioneve me shoqërinë civile dhe aktivistët e komunitetit LGBT, një nga problematikat e konstatuara lidhur me çështjen e azilkërkesve shqiptarë në BE, ka qenë se diskriminimi i komunitetit LGBT (Komuniteti i Lezbikeve, Gejve, Biseksualëve e Transgjinjorëve) ka shërbyer si motiv për kërkimin e azilit për disa shtetas shqiptarë, që i përkasin këtij komuniteti.

Komuniteti LGBT në Shqipëri, në bazë të legjislacionit në fuqi, gëzon të drejta dhe liri të barabarta me të gjithë pjesëtarët e tjerë të shoqërisë. Sidoqoftë ka ende një rrugë të gjatë përpara në mënyrë që pjesëtarët e këtij komuniteti të ndihen si të barabartë me pjesën tjetër të popullsisë dhe që të drejtat e tyre të respektohen dhe zbatohen plotësisht.

Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar një sërë aktesh ndërkombëtare që garantojnë të drejtat e njeriut, përfshirë edhe të drejtat e komunitetit LGBT:

- Konventa mbi Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit. Paris, 9 dhjetor 1948.
- Konventa ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor. New York, 7 mars 1966.
- Amendim i nenit 8 të Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor. New York, 15 janar 1992.
- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. New York, 16 dhjetor 1966.
- Protokolli Fakultativ i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. New York, 10 dhjetor 2008.
- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike. New York, 16 dhjetor 1966.

- Protokoll i Fakultativ i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike. New York, 16 dhjetor 1966.
- Konventa mbi mos-zbatueshmërinë e kufizimeve ligjore për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. New York, 26 nëntor 1968.
- Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin dhe Dënimin e Krimit të Aparteidit. New York 30 nëntor 1973.
- Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave. New York 18 dhjetor 1979.³²

Institucioni i Avokatit të Popullit ka qenë gjithnjë dhe vijon të jetë një mbështetës i fuqishëm për të drejtat e komunitetit LGBT në Shqipëri. Në këtë kuadër Avokati i Popullit ka hartuar disa rekomandime, që synojnë përmirësimin e garantimit të të drejtave të njeriut për këtë komunitet:

1. Përfundimin e një Plani Kombëtar Veprimi për Masat për mbrojtjen e të drejtave të personave LGBT. Avokati i Popullit sugjeron që ky plan të jetë gjithëpërfshirës në drejtim të institucioneve që do ta hartojnë, por edhe zbatojnë atë, si dhe të jetë sa më i plotë në drejtim të aktiviteteve, masave, treguesve, indikatorëve dhe buxheteve që do të programohen për realizimin e çdo mase.
2. Ndryshimin e Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë:
 - Përfshirjen në pikën 2, të nenit 9 të nignit 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, si shkaqe për diskriminim edhe “orientimin seksual dhe identitetin gjinor”.
 - Përfshirja në fund të nenit 9 të ligjit 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të një paragrafi të ri, në të cilin të përcaktohet se mbi cilën palë bie barra e provës, për rastet kur pretendohet se ka patur diskriminim mbi personin. Paragrafi i formuluar duhet të jetë në përputhje të plotë me përcaktimet e nenit 10 të Direktivës 2000/78 EC, pra duke e vendosur barrën e provës mbi punëdhënësin.
3. Në vijim të plotësimit të rekomandimit të sipërcituar, duhet që autoritetet shtetërore përgjegjëse, Inspektorati Shtetëror i Punës të kontrollojë zbatimin nga punëdhënësit të dispozitave të ndryshuara, në mënyrë që të garantojë edhe zbatimin në praktikë të

³² Raport i posaçëm i veprimtarisë së Avokatit të Popullit për të drejtat e personave LGBT, Avokati i Popullit, Tiranë, 2012.

dispozitës, nga punëdhënësit publik apo privatë. Rekomandim i pranuar nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

4. Përfshirjen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në kurrikula dhe programe mësimore të njohurive dhe informacioneve për komunitetin LGBT, me qëllim arsimimin në një mjedis të sigurt pa dhunë, fyerje, përjashtim social apo trajtim çnjerëzor lidhur me orientimin seksual ose me identitetin gjinor.
5. Trajnimin nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, i stafit akademik për moslejimin e çdo forme diskriminimi duke siguruar mbrojtje dhe disiplinë në institucionet arsimore për shkak të përkatësisë së tyre seksuale. Rekomandim i pranuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Duhet theksuar se një arritje shumë e rëndësishme është arritur nëpërmjet mendimit të Kodit Penal, ku janë reflektuar edhe rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit, përkatësisht:

Ndryshimi i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, plotësimin e tij në nenin 50, germa “j” duke parashikuar edhe orientimin seksual si motiv që përbën rrethanë rënduese. Pra, në germën “j” të nenit 50 të ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pas fjalës “gjininë” të shtohet shprehja “orientimi seksual”. (ngacmimi moral ne pune, ngacmimi moral ne shtëpi, ngacmimi seksual). Rekomandim i pranuar nga Ministria e Drejtësisë. Dhe i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Disa nga problemet e tjera që përfshijnë komunitetin LGBT janë kujdesi shëndetësor, implementimi i projekteve kërkimore dhe studimore, dhuna në familje dhe shoqëri, martesë brenda personave të të njëjtit seks, etj.

Një problem tjetër, është se Shqipëria nuk disponon të dhëna për situatën në komunitetin LGBT në shkolla, mjedisin e punës dhe atë shoqëror. Në vendin tonë perceptimet për këtë komunitet njihen vetëm në formë në diskutimeve të lira, por nuk ka asnjë studim të mirëfilltë që të studioj situatën LGBT në raport me fushatën e mësipërme.

Ndërkohë Shqipëria, në fakt, përveç ligjit anti-diskriminim, nuk ofron asnjë lloj mbrojtje tjetër për komunitetin LGBT, qoftë kjo në arsim, punë, shëndetësi, administratë, gjykata, politikë, etj.

LGBT vuajnë nga dhuna dhe abuzimet në Shqipëri. Kjo dhunë, e cila mund të jetë verbale dhe fizike identifikohet mospranimi të identitetit seksual të personave LGBT e cila në raste ekstreme shoqërohet me të ashtu-quajtura krime urrejtje.

Shqipëria, nuk ofron mbrojtje ligjore për personat LGBT nga krimet e urrejtjes.

Gjithashtu, sipas studimit, sa më i madh të jetë vizibiliteti i komunitetit në shoqëri aq më të mëdhaja në gjasat që ai të vuajë agresion.

Dhuna ndaj komunitetit LGBT.

Në Shqipëri kjo vërtetohet nga komuniteti Transgjinnor të cilët vuajnë prej vitesh dhunë nga qytetarë të ndryshëm .

Ndër të tjera përmendim se, komunitetet LGBT në Shqipëri vuajnë nga dhuna në familje.

Shqipëria, nuk mbledh ende të dhëna për dhunën në raport me orientimin seksual dhe ky mbetet një problem.

Edhe pse e drejta e personave LGBT për tu mbledhur dhe shprehur është e garantuar me ligj në pjesën më të madhe të shteteve anëtare, faktet tregojnë se komuniteti LGBT mund të përballlet me mohimin dhe refuzimin e këtyre të drejtave nga shoqëria dhe institucionet.

Në këtë kuptim, komuniteti LGBT në Shqipëri vazhdon të mos ketë asnjë eksperiencë, duke qenë se ndër vite ka vuajtur padukshmërinë.

Martesa brenda personave të të njëjtit seks. Nëse disa shtete Evropiane kanë bërë hapa pozitive në njohjen dhe garantimin e të drejtës për tu martuar brenda personave të të njëjtit seks, ndërkohë që Shqipëria nuk e ofron ende këtë të drejtë, ashtu siç nuk ofron dhe garanton as të drejtën në bashkëjetesë apo në partneritet civil.

Shqipëria nuk e njeh të drejtën e personave transgjinnorë për tu martuar me emrin dhe gjininë e përzgjedhur prej tyre.

Kujdesi shëndetësor ndaj komunitetit LGBT.

Studimet tregojnë se mjaft stafe mjekësore dhe spitalore, vazhdojnë ta trajtojnë homoseksualitetin si një sëmundje mendore dhe ushtrojnë trajtim të diferencuar.

Të diferencuar ndaj personave LGBT që pranojnë haptazi orientimin e tyre seksual.

Studimet tregojnë gjithashtu, se personat LGBT kanë shanse të kenë më shumë problem shëndetësorë sesa pjesa tjetër e shoqërisë duke theksuar këtu problemet me depresionin dhe shqetësimet emocionale të shkaktuara nga izolimi shoqëror.

Stafet mjekësore, në Shqipëri kanë nevojë për shumë trajnime në këtë fushë. Besimi i komunitetit LGBT në Shqipëri, ndaj shërbimeve mjekësore mbetet shumë i ulët.

Programi mbështetës i Avokatit të Popullit Pro Aleancës LGBT përfshin: Advokaci dhe lobim me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, aktorë qeveritarë, dhe bashkësinë ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT në Shqipëri.

Gjithë sa më sipër, tregon për domosdoshmërinë e implementimit të strategjive monitoruese dhe vëzhguese për të kuptuar se cilat janë format dhe nivele të diskriminimit në Shqipëri.

Në këtë sektor dhe se ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, edhe pse një fillim shumë i mbarë, mbetet maja e ajsbergut në raport me mbrojtjen dhe garantimi në të drejtave të komunitetit LGBT në vend.

Institucioni i Avokatit të Popullit është i vetëdijshëm që çështjet e trajtuara nga ai, janë vetëm një pjesë e shqetësimeve dhe problemeve që kanë personat që i përkasin komunitetit LGBT. Në këtë kontekst, puna e institucionit tonë në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, por edhe me autoritetet shtetërore përgjegjëse, ka qenë dhe do vazhdojë të jetë aktive për të synuar mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të personave LGBT, edhe në fusha apo për çështje të tjera. Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e parashikuara në ligj, do të vazhdojë aktivitetin e tij në drejtim të përmirësimit të situatës së zbatimit të masave të parashikuara për komunitetin LGBT, në rekomandimin 11 të BE për Shqipërinë, duke dhënë edhe kontributin e tij lidhur me këto çështje.

4.3. Fenomeni i gjakmarrjes në Shqipëri.

E drejta e jetës mbrohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 21), disa akte ndërkombëtare, si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e OKB (1948), Konventa Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e Këshillit të Evropës (1950), si dhe Kodi Penal (nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 81, 82, 83).

Jeta është një e drejtë, atribut themelor i qënies njerëzore dhe kur kjo jetë hiqet ose merret, në çfarëdo lloj mënyre, njeriu, në të njëjtën kohë, eliminohet si mbartës të drejtash dhe detyrimesh. Jeta e njeriut duke pasur një vlerë të padiskutueshme është bërë objekt i mbrojtjes kushtetuese. Gjatë viteve të tranzicionit pothuajse çdo ditë në kronikat e zeza të

medias informohemi për humbje jetësh njerëzore në rrethana dhe motive nga më të ndryshme, ndër të tjera edhe për shkak të gjakmarrjes.

Gjakmarrja në Shqipëri tashmë është kthyer në një fenomen shumë shqetësues për shoqërinë tonë sepse cenon të drejtën më të rëndësishme të njeriut, të drejtën e jetës. Ndërkohë shqetësimin e këtij fenomeni dhe sidomos vitet e fundit po e vuajnë edhe disa vende të BE për shkak të numrit në rritje të azilkërkuesve shqiptar të cilët pretendojnë se u rrezikohet jeta në Shqipëri për shkak të këtij fenomeni. Raporte të ndryshme në lidhje me azilkërkuesit, nxjerrin që një ndër faktorët kryesorë në kërkesen për azil të shtetasve shqiptar në BE ka të bëjë me gjakmarrjen.³³

Për shkak të gjakmarrjes në vendin tonë kanë lindur edhe disa pasoja të tjera negative dhe regresive sikurse mund të përmendim *ngujimin e personave pa dallim gjinie e moshe*, duke u mohuar personave të ngjuar një sërë të drejtash kushtetuese themelore, si atë të lëvizjes së lirë, të arsimimit, të punësimit, të përfitimit të kujdesit shëndetësor, të votimit, të lirisë së organizimit, të lirisë së bindjes dhe shfaqjes së saj etj.

Reagimi i Avokatit të Popullit lidhur me këtë fenomen.

Duke vlerësuar të drejtën e jetës si të drejtën themelore dhe më të rëndësishme të njeriut, duke pranuar edhe rrezikun që e kanos çdo ditë këtë të drejtë, Avokati i Popullit në bashkëpunim me Fondacionin “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Mosmarrëveshjeve”, në 11-12 dhjetor 2001 organizoi një Konferencë Kombëtare me temë: “*Shteti dhe Shoqëria Civile në Mbrotjtje të së Drejtës së Jetës*”.

Me iniciativën dhe nxitjen e Avokatit të Popullit, Kuvendi miratoi ligjin nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”. Ky ligj ka si qëllim të organizojë dhe të koordinojë më mirë masat dhe luftën e organeve shtetërore, institucioneve shoqërore, shkencore, fetare etj., si dhe të përcaktojë një strategji afatgjate për parandalimin dhe eliminimin e fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri. Gjatë vitit 2012 Avokati i Popullit ka rimarrë iniciativën për sensibilizimin e institucioneve shtetërore, shoqërisë civile, medias dhe individëve në çështjen sensitive të gjakmarrjes.

³³ Asylum applicants from the Western Balkans comparative analysis of trends, push-pull factors and responses, EASO, 2013, faqe 43.

Gjatë shqyrtimit të këtij fenomeni konstatoam se një nga shkaqet që ka ndikuar negativisht për ekzistencën e tij është edhe moszbatimi i ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”, ndonëse ka mbi 8 vjet që ka hyrë në fuqi.

Gjithashtu kemi konstatuar se shkak për moszbatimin e këtij ligji ka qenë mos nxjerrja nga KM i tre akteve nënligjore në bazë e për zbatim të nenit 7 të ligjit.

Ne gjykojmë se ishte me shumë rëndësi nxjerrja e tre akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave në bazë e për zbatim të detyrimeve ligjore që burojnë nga neni 7 ligjit të sipërcituar. Për këtë arsye me shkresën e datës 28.08.2012 i kemi rekomanduar Këshillit të Ministrave: *“Marrjen e masave të menjëhershme në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes” për përgatitjen dhe nxjerrjen nga Këshilli i Ministrave të akteve nënligjore të parashikuara në nenet 4, 5 dhe 6 të këtij ligji”*.

Ministri i Drejtësisë me shkresën e datës 20.03.2013 na informoi se rekomandimi ynë drejtuar Këshillit të Ministrave ishte mirëpritur. Në zbatim të tij ishte përgatitur dhe nxjerrë Urdhri i Kryeministrit nr. 136, datë 14.11.2012 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”, i cili kryesohet nga Zëvendësministri i Brendshëm.

Meqenëse nuk kishim ndonjë informacion lidhur me hartimin apo jo të akteve nënligjore të cituara më sipër, Avokati i Popullit me shkresat e datës 27.11.2013 dhe 09.01.2014 i ka kërkuar Ministrit të Brendshëm informacion lidhur me përgatitjen (hartimin) nga grupi i punës të akteve nënligjore në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005.

Ndërkohë gjykojmë se thirrja e Këshillit Koordinues jo vetëm që është një detyrim ligjor, por do të jetë edhe një nxitje dhe mbështetje e madhe ndaj organeve shtetërore të përfshira drejtpërdrejtë në luftën kundër fenomenit të gjakmarrjes për të kryer detyrat ligjore. Për këto arsye i kemi kërkuar tre herë Presidentit të Republikës (një herë z. Topi dhe dy herë z. Nishani në datë 12.03.2013 dhe 27.11.2013) thirrjen e Këshillin Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes. Një përgjigje është kthyer nga Sekretari i Përgjithshëm i Presidencës së

Republikës, ku ndër të tjera në bën me dije që Presidenti nuk mund ta thërrasi Këshillin Koordinues nëse nuk janë miratuar 3 aktet nën-ligjore të larpermendura.

Është ngritur një grup task-forcë për ndjekjen dhe hetimin e rasteve kur strukturat shtetërore nuk veprojnë për parandalimin apo ndjekjen e rasteve të ngjarjeve që lidhen me gjakmarrjen. Është hetuar një rast vrasjeje për motive hakmarrje në Pukë, ku u provua se vrasja e dy personave dhe plagosja e katër të tjerëve ndodhi për shkak të neglizhencës së punonjësve të policisë.

Është organizuar një Kuvend i Hapur në Shkodër me pjesëmarrjen e disa përfaqësuesve të organeve qendrore të administratës shtetërore, të pushtetit vendor, OJF-ve, komuniteteve fetare, personaliteteve publike të vendit dhe të medias etj.

Është organizuar një aktivitet me fëmijët e ngjuar tek Avokati i Popullit.

Është përgatitur dhe dërguar në Kuvend një Raport i Veçantë për fenomenin e gjakmarrjes, bazuar në eksperiencën institucionale dhe në të dhënat e marra nga institucionet shtetërore.

Në datat 10 e 11 dhjetor 2013 nga institucioni i Avokatit të Popullit u organizua një Konferencë Kombëtare me pjesëmarrjen e disa institucioneve publike dhe OJF-ve. Një seancë e kësaj konference iu kushtua fenomenit të gjakmarrjes në të cilën morën pjesë edhe disa ministra.

Disa konkluzione dhe rekomandime të dala nga Konferenca e organizuar për gjakmarrjen më 11.12.2013.

Gjakmarrja në Shqipëri ndonëse e lokalizuar në disa zona është kthyer në një fenomen shumë shqetësues për shoqërinë tonë sepse cenon të drejtën më të rëndësishme të njeriut, të drejtën e jetës. Për shkak të saj kanë lindur edhe disa pasoja të tjera negative sikurse mund të përmendim, ngujimin e personave pa dallim gjinie e moshe, duke iu mohuar një sërë të drejtash kushtetuese themelore, si atë të lëvizjes së lirë, të arsimimit, të punësimit, të përfitimit të kujdesit shëndetësor, të votimit, të lirisë së organizimit, të lirisë së bindjes dhe shfaqjes së saj etj.

Ndërkohë shqetësimin e këtij fenomeni dhe sidomos vitet e fundit po e ndiejnë dhe vuajnë edhe disa vende të BE për shkak të numrit në rritje të azilkërkuesve shqiptar duke përfshirë edhe ata fiktivë të cilët pretendojnë se u rrezikohet jeta në Shqipëri për shkak të këtij

fenomeni. Gjakmarrja nuk është vlerësuar seriozisht nga strukturat shtetërore, të cilat fatkeqësisht nuk kanë dëshiruar që ta pranojnë atë. Këtë qëndrim e tregon edhe fakti që nuk ka statistika të sakta nga policia për numrin e të vrarëve për gjakmarrje, të familjeve dhe të personave të ngjuar. Kjo ndodh edhe për faktin se fenomeni është dinamik.

Fenomeni është mesjetar, kriminal dhe jo i pastër kanunor.

Fëmijët e ngjuar janë të destinuar të bëhen kriminelë për shkak të rrethanave ku jetojnë, të ndjenjës së urrejtjes me të cilën rriten dhe mungesës së shkollimit.

Nuk ka asnjë investim nga organet e shtetit dhe të drejtësisë për të nxjerrë personat nga ngujimi.

Disa masa të marra për shtesa e ndryshime në Kodin Penal, duke rritur dënimin për autorët e vrasjes për gjakmarrje (jo më pak se 30 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm neni 78/a i KP) dhe parashikimin e dy figurave të reja krimi, si *kanosja serioze për tu mbyllur në shtëpi* (neni 83/a i KP) dhe *nxitja për gjakmarrje* (neni 83/b i KP për të cilat parashikohet dënimi me burgim deri në tre vjet) nuk janë të mjaftueshme për të luftuar këtë fenomen.

Ligji nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes” ndonëse ka mbi 8 vjet që ka hyrë në fuqi nuk ka gjetur zbatim. Kjo situatë duhet të marrë fund menjëherë dhe strukturat qendrore e vendore të parashikuara prej tij duhet të fillojnë punën e tyre intensive duke hartuar e miratuar strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit për luftën kundër gjakmarrjes në planin ekonomik, social, legjislativ etj. dhe përcaktojnë detyrat dhe masat konkrete për organet administratës qendrore dhe ato të pushtetit vendor.

Gjakmarrja nuk mund të zhduket për një vit apo për një mandat qeverisës por është e rëndësishme që të filloj puna intensive për ta luftuar atë. Gjakmarrja mund të luftohet me efektivitet vetëm në qoftë se strukturat shtetërore, shkollat, komunitetet fetare, media dhe shoqëria civile do të punojnë së bashku sipas një strategjie të përbashkët dhe planit të veprimit të miratuar nga qeveria.

Organet e pushtetit vendor duke përfshirë edhe ato të policisë duhet të evidentojnë saktësisht numrin e familjeve dhe të personave të ngjuar. Policia e Shtetit duhet të mbajnë statistika të sakta për numrin e të vrarëve për gjakmarrje, të familjeve dhe të personave të ngjuar. Organet e Policisë së Shtetit duhet të marrin masa të menjëhershme për parandalimin e konflikteve të ndryshme që janë një nga burimet e krimeve për hakmarrje e gjakmarrje, për

zbulimin dhe kapjen sa më shpejt të autorëve të krimeve për gjakmarrje. Organet e prokurorisë duhet të bashkëpunojnë më mirë me policinë për të bërë hetime të shpejta, të plota, të thella dhe objektive. Nuk duhet mjaftuar vetëm me zbulimin e autorit të vrasjes, ekzekutorit, por duhen zbuluar edhe bashkëpunëtorët e tij, sikurse janë nxitësit e ndihmësit e autorit si dhe organizatorët e krimit. Gjykatat duhet t'i gjykojnë shpejt, me objektivitet, paanshmëri dhe mundësisht me gjykim të pandërprerë çështjet gjyqësore për këtë krim dhe të japin dënime të drejta për çdo fajtor. Çdo dënim i butë, apo pafajësi e pabazuar i lë shteg vetëgjyqësisë, hakmarrjes e gjakmarrjes. Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të luajë rol më të madh pozitiv e parandalues për përmirësimin e programeve mësimore, që të sigurohet mirë arsimimi dhe mirë edukimi i brezit të ri me frymën e tolerancës, jo dhunës, pranimit e diversitetit, kundër vetëgjyqësisë, hakmarrjes e gjakmarrjes. Trajnimi i mësuesve të zonave, ku është e përhapur gjakmarrja është i rëndësishëm. Duhet të vazhdoj edhe për disa kohë Projekti “Shansi i dytë” nëpërmjet të cilit të përfitojnë të gjithë fëmijët e ngjuar dhe jo vetëm në qarkun e Shkodrës por edhe në qarqe të tjera të vendit.

Familjet e ngjuara janë në gjendje të mjerueshme ekonomike. Problemet sociale të familjeve të ngjuara kërkojnë një angazhim më të madh të shtetit, posaçërisht të Ministrisë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, që, nëpërmjet zyrave rajonale, të shkojnë tek familjet e ngjuara për ti dhënë mundësi të aplikojnë për ndihmë ekonomike atyre familjeve me të ardhura të pamjaftueshme me qëllim uljen e nivelit të varfërisë. Ministria e Shëndetësisë me strukturat e saj duhet tu ofrojë familjeve të ngjuara nga gjakmarrja shërbim shëndetësor në shtëpi sipas paketës bazë të Kujdesit Shëndetësor Parësor, që çdo qendër shëndetësore nëpërmjet mjekut të familjes u ofron pacientëve që janë regjistruar pranë saj.

Të mbahen lidhje të vazhdueshme dhe të bashkëpunohet me OJF që veprojnë dhe kontribuojnë për këtë problem kryesisht në zonën e Shkodrës.

Në vijim, ditët e fundit janë bërë disa rekomandime organeve shtetërore sikurse mund të përmendim:

1. Rekomandimi drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit që të bashkëpunojë me organet e pushtetit vendor dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale për regjistrimin e të gjitha vrasjeve për motiv gjakmarrjeje, të familjeve dhe të personave të ngjuar sipas gjinisë dhe grup moshave (meshkuj, femra, të mitur).

2. Rekomandimi drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit që të luajë rol më të madh pozitiv e parandalues për përmirësimin e programeve mësimore, që të sigurohet mirë arsimimi dhe mirë edukimi i brezit të ri me frymën e tolerancës, jo dhunës, pranimin e diversitetit, kundër vetëgjyqësisë, hakmarrjes e gjakmarrjes. Trajnimin e mësuesve të zonave, ku është e përhapur gjakmarrja. Vazhdimin edhe për disa kohë të Projektit “Shansi i dytë” nëpërmjet të cilit të përfitojnë të gjithë fëmijët e ngjuar në të gjitha qarqet e vendit.
3. Rekomandimi drejtuar Ministrisë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, që, nëpërmjet zyrave rajonale, të shkojnë tek familjet e ngjuara për ti dhënë mundësi të aplikojnë për ndihmë ekonomike atyre familjeve me të ardhura të pamjaftueshme me qëllim uljen e nivelit të varfërisë.
4. Rekomandimi drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë që tu ofrojë personave të ngjuar nga gjakmarrja shërbim shëndetësor në shtëpi sipas paketës bazë të Kujdesit Shëndetësor Parësor, që çdo qendër shëndetësore nëpërmjet mjekut të familjes u ofron pacientëve që janë regjistruar pranë saj.

Kohët e fundit ka patur një reagim pozitiv të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe kemi bindjen se ai do të ndikojë dhe influencojë në parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes në rrethin e Shkodrës dhe për daljen e të ngjuarve. Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka nxjerrë një urdhër për identifikimin dhe administrimin e kallëzimeve të familjeve të ngjuara. Ky urdhër detyron organet vendore të Policisë së Shtetit, që të evidentojnë të gjitha familjet dhe personat që ndodhen të ngjuar për shkak të gjakmarrjes. Gjithashtu urdhërohen oficerët e policisë gjyqësore që të marrin kallëzime nga personat të cilët janë kanosur për t’u ngjuar.

Ne e vlerësojmë këtë veprim ligjor dhe ndërkohë gjykojmë se ky veprim pozitiv duhet të shtrihet edhe në organet e tjera të prokurorisë dhe konkretisht në ato rrethe të cilat janë prekur nga fenomeni i ngujimit për shkak të gjakmarrjes.

Për këto arsye, me shkresën e datës 03.03.2014 i kemi rekomanduar Prokurorit të Përgjithshëm marrjen e masave të nevojshme që, nisma pozitive e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër “Për identifikimin dhe administrimin e kallëzimeve të familjeve të ngjuara”, të shtrihet edhe në organet e tjera të Prokurorive të Rretheve Gjyqësore në ato rrethe të vendit të cilat janë prekur nga fenomeni i ngujimit për shkak të gjakmarrjes.

4.4. Dhuna ndaj grave.

Dhuna ndaj gruas është një problem kompleks që përfshin më shumë se sa një akt në vetvete në marrëdhëniet personale mes burrit dhe gruas. Është një problem social me përmasa të gjera që i ka rrënjët në qëndrimet historike ndaj gruas dhe marrëdhënieve martesore. Viktimizimi i grave nga bashkëshortët e tyre përforcohet nga gjendja ekonomike, mentaliteti dhe tradita, ndërgjegjësimi jo i mjaftueshëm i njerëzve mbi dhunën në familje.

Vështirësia e studimit të fenomenit rritet edhe më shumë po të kemi parasysh se ai ndodh “pas dyerve të mbyllura” të familjes. I vetmi burim informacioni mbetet në shumicën e rasteve vetë viktima, e cila në çdo rast nuk është e çliruar nga paragjykimet dhe stereotipat që ekzistojnë në shoqëri apo në komunitetin ku ajo bën pjesë. Ndërsa dhuna ndaj gruas po bëhet gjithmonë dhe më shumë problem shqetësues në shoqëri, pasi shumë burra ndihen të kërcënuar nga koncepti i lirisë së grave. Studimi i dhunës në familje vështirohet po të kemi parasysh edhe një numër mitesh që nuk lejojnë depërtimin në thelbin e problemit. Kështu, në komunitete dhe ambiente të ndryshme sociale ndahen mendime se “dhuna prek vetëm një shtresë apo grupe të caktuara”, “dhuna është një problem i të varfërve”, “gratë e dhunuara kanë personalitete të caktuara që e nxisin ushtrimin e dhunës nga bashkëshorti”, etj.

Zakonet dhe traditat shqiptare trashëgojnë nga e kaluara disa forma të diskriminimit të gruas në familje dhe në shoqëri, por jo të tipit të torturës, apo të formave të tjera të keqtrajtimit. Dukuria e gjakmarrjes që u rigjallërua pas viteve '90, sidomos në disa zona të vendit, ka sjellë probleme edhe për gratë, por veçanërisht për fëmijët. Gjakmarrja është bërë pengesë për një jetë normale të tyre edhe për shkak të vështirësive që sjell ngujimi i burrave dhe i fëmijëve. Rastet kur për gjakmarrje është qëlluar mbi gruan paraqiten të rralla. “Kanuni”, praktikohet ende në Shqipëri, veçanërisht në Veri. Fatkeqësisht, pas viteve '90, shihet një riaktivizim i këtij kodi.

Puna parandaluese, që bëhet nga organizatat jofitimprurëse, është shoqëruar me miratimin e ligjeve përkatëse për dhunën në familje, por edhe me kujdesin për të hetuar dhe gjykuar me rreptësi çdo shfaqje dhune që përbën vepër penale. Duhet të ketë më shumë mjete efektive në kuadrin e një mekanizmi, për të garantuar që të ruhen dhe zbatohen të drejtat e grave, për të përmirësuar trajtimin dhe pozitën e femrave në familje dhe në shoqërinë shqiptare. Gjithashtu

organet shtetërore duhet të punojnë për realizimin e detyrimeve të tyre për t'i shkuar drejtësisë deri në fund, pavarësisht se viktimat e kësaj dhune mund të heqin dorë nga akuza për një arsye apo tjetër. Nuk duhet harruar se dhuna në familje nuk është atribut vetëm i familjeve të varfra apo atyre me shkollim të pamjaftueshëm, si dhe ajo ka prekur dhe preket edhe familjet në gjendje të mirë ekonomike dhe me arsim të lartë. Marrëdhënia seksuale me dhunë ende konsiderohet “turp” për gruan dhe në disa raste (veçanërisht në zona rurale) pas, sjell martesën e detyruar me përdhunuesin “për të vënë nderin në vend”. Megjithatë, në zonat urbane, situata ka ndryshuar, por në shumicën e zonave rurale e sub-urbane gruaja vazhdon të jetë nën trysinë e mendësisë patriarkale.

Dhuna në familje është një problem që prek të gjitha shtresat dhe grupet e shoqërisë, pa dallim race, etnie, niveli ekonomik, zone gjeografike, besimi fetar, moshe, etj. Nga të dhënat në nivel botëror, të mbledhura në dhjetë vitet e fundit rezulton se dhuna ndaj grave është një pengesë në procesin e zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Llogaritja e kostove social-ekonomike të dhunës në familje, përbën një ndërhyrje strategjike në ndërgjegjësimin e politikë bërësve për rëndësinë dhe efektivitetin e parandalimit të saj. Duke qenë se dhuna në familje është një çështje tepër sensitive në vende dhe rajone të ndryshme, për adresimin e saj duhen programe dhe strategji në përputhje me kulturën e tyre.

Në kohën tonë familja e ka humbur “qetësinë”, dhe është e kërcënuar jo vetëm nga faktorë tradicionalë, si vdekja, sëmundjet, katastrofa të ndryshme, varfëria, etj., por dhe ata “jo tradicionalë” si sjelljet devijante, konfliktet gjithfarëshe, dhuna, alkoolizmi, përdorimi abuziv i drogës, braktisja, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, etj.”. Pra familja është një strukturë që përmbledh një mori marrëdhëniesh dhe rolesh dhe si e tillë është e ndjeshme nga dhuna që ushtrohet brenda saj.

Shqipëria ka ndërmarrë angazhime ligjore të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare për të luftuar diskriminimin dhe për të promovuar e bërë realitet barazinë gjinore. Raportimet e bëra në kuadër të integritimit në Bashkimin Evropian kanë evidentuar se tashmë Shqipëria ka plotësuar kuadrin ligjor në mbështetje të barazisë gjinore dhe reduktimit të dhunës në familje, si dhe ka një strategji të qartë për të patur rezultate pozitive. Sfida dhe rekomandimet kanë të bëjnë me zbatimin e mëtejshëm të këtyre dokumenteve ligjorë e politikë të rëndësishëm.

Parashikimi i dhunës në familje si vepër penale dhe iniciativat ligjore që po ndërmerren për ashpërsimin e dënimeve ndaj dhunuesve; ratifikimi i Konventës Evropiane “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”; zbatimi i ligjit nga policia dhe profesionistët e tjerë të drejtësisë; përfshirja e djemve dhe burrave në ndërgjegjësim i cili do të jetë proces në vazhdimësi edhe gjatë vitit 2014; ngritja e kapaciteteve dhe fuqizimi i strukturave në mbështetje të barazisë gjinore dhe dhunës në familje janë arritje të rëndësishme. Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe mbështetja e dhënë në kuadër të Programit “Një OKB” dhe donatorët e tjerë si OSBE, Këshilli Evropës etj., janë pjesë e pandashme e procesit të integritimit gjinor dhe luftës kundër diskriminimit gjinor.

Ka patur një bashkëpunim të mirë të ministrisë së linjës me OJF-të e fushës, të cilat me aktivitetet dhe projektet e tyre kanë dhënë një kontribut të mirë në drejtim të zbatimit të objektivave të Strategjisë, rritjes së pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrjen politike; Fuqizimit ekonomik të grave, fushatave sensibilizuese për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave dhe parandalimit të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje; aktiviteteve të ndryshme ndërgjegjësuere, tryezave të rrumbullakëta dhe seminareve, emisioneve, shkrimeve në masmedia, botimeve, etj.

Arritje në fushën e legjislacionit

1. Një nga ndryshimet më të rëndësishme ligjore është parashikimi i dhunës në familje si vepër penale në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Me ndryshimet e bëra në Kodin Penal, me ligjin nr. 23, datë 01.03.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhuna në familje është parashikuar si vepër penale në Nenin 130/a, i cili parashikon format e dhunës, masat si dhe rrethin e subjekteve që mbrohen nga ky nen. Gjithashtu ndryshimet kanë përfshirë dhe abuzimin sistematik psikologjik dhe ekonomik.
2. Me ligjin nr. 104/2012, datë 08.11.2012 u ratifikua nga Kuvendi i Shqipërisë Konventa e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”. Me ratifikimin e kësaj Konvente Shqipëria shpreh edhe njëherë angazhim për të bashkëpunuar edhe në nivel rajonal dhe ndërkombëtar kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, si dhe marrjen e masave legjislative, politike dhe ekzekutive për të luftuar kundër fenomenit.
3. VKM nr. 465, datë 16.7.2012 “Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm” . Me këtë vendim tashmë të gjitha institucionet qendrore duke filluar nga

viti 2013 do të planifikojnë në buxhetet e tyre objektiva të matshme për barazinë gjinore.

4. Me VKM nr. 425, datë 27.06.2012 janë miratuar “Kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jo publike, të përkujdesjes shoqërore”. Në Kreun V për viktimat e dhunës në familje janë përcaktuar kriteret për vendosjen në qendrat rezidenciale të përkujdesjes shoqërore.
5. VKM nr. 27, datë 16.01.2012 “Për nxitjen e punësimit të punëkërkuessve femra nga grupet e veçanta”. Programi synon të nxisë drejtuesit dhe menaxheret shqiptare për të punësuar punëkërkuessve të papunë femra nga grupet vulnerabël, të cilat kanë vështirësi për të hyrë në tregun e punës. Kjo mbështetje konsiston në financimin e masës së detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe çdo të punësuar (sipas këtyre programeve) i paguhen katër paga minimale zyrtare në vit.
6. Është në proces miratimi në Këshillin e Ministrave, projektvendimi i cili do të bëjë të mundur tërheqjen dhe marrjen në dorëzim të ndihmës ekonomike nga bashkëshortja. Ndërsa për pronësinë nuk ka fushë përgjegjësie shtetërore Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Konkluzione dhe rekomandime:

Rekomandimi 11 i BE për Shqipërinë përcakton se duhet:

“Të bëhen hapa konkrete në forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, sidomos të grave, fëmijëve dhe romëve, si dhe në zbatimin e efektshëm të politikave anti-diskriminim”. Ndaj në kuadër të *organizimit të fushatave të ndërgjegjësimit për parandalimin e dhunës gjinore dhe dhunës në familje*, *puna e Institucionit të Avokatit të Popullit ndër të tjera do të vijojë me organizimin e ditëve të hapura, inspektimet e vazhdueshme dhe në qendra ku strehohen gratë e trafikuarra. Gjithashtu objekt i punës në vazhdim nga Institucioni i Avokatit të Popullit, do të jetë edhe vlerësimi dhe monitorimi i zbatimit të detyrimeve ligjore dhe nënligjore nga autoritetet shtetërore përgjegjëse sipas fushës së veprimtarisë së tyre.*

1. Bashkëpunimi i vazhdueshëm i Avokatit të Popullit me organizatat jofitimprurëse, që së fundmi është materializuar në marrëveshjet e përbashkëta të bashkëpunimit, do të përqendrohet kryesisht në trajtim (referim) rastesh, ndërgjegjësim komuniteti lidhur me të drejtat e grave-aktivitete të përbashkëta, etj., dhe hartim rekomandimesh. Marrëveshjet e bashkëpunimit të Avokatit të Popullit me organizata të shoqërisë civile në mbrojtje të të drejtave të grave, do të bëjnë të mundur që vetë shoqëria civile “ta përdorë efektivisht Avokatin e Popullit për të përçarur mesazhe të rëndësishme lidhur

me gjendjen e të drejtave të grave ndaj të cilave duhet ndërhyrje ligjore, administrative, etj”.

2. Është rritur numri i individëve që i drejtohen gjykatës për arsye të dhunës si dhe numri i urdhër mbrojtjeve të lëshuara prej tyre. Vihet re që ndër vitet e zbatimit, ka pasur një zgjerim të numrit të gjykatave që kanë lëshuar urdhra mbrojtjeje për viktimat e dhunës në familje, duke mos mbetur vetëm në gjykatat e qyteteve të mëdha, por edhe në ato të rretheve më të vogla. Shtimi i numrit të vendimeve për urdhrat e mbrojtjes të lëshuara nga Gjykata tregon se është rritur ndërgjegjësimi, reagueshmëria dhe besimi i viktimave të dhunës në sistemin e mbrojtjes. Mirëpo, shpejtësisë së gjykatës nuk i përgjigjen strukturat e përmbartimit, të cilat duket se e gjejnë të vështirë në terren zbatimin e vendimeve gjyqësore.
3. Dhuna në familje është një fenomen mjaft i përhapur në shoqërinë shqiptare dhe si rrjedhojë, është përgjegjësia e shtetit, komunitetit dhe individëve të ndërmarrin veprimet e nevojshme për ta ndaluar atë. Është e domosdoshme që qeveria të ndërmarrë iniciativat e duhura kundër këtij fenomeni në mënyrë që të respektojë dhe plotësojë të drejtat themelore të grave dhe fëmijëve si pjesë e të drejtave të njeriut. Pavarësisht nga iniciativat dhe aktivitetet e organizatave të ndryshme, veprimet e ndërmarra nga shteti kanë mundësinë të unifikojnë dhe të konsolidojnë këto përpjekje dhe pse jo t'i nxisin dhe promovojnë.
4. Procesi i dëmshpërblimit të gruas që ka pësuar torturë ose dhunë seksuale, ose forma të tjera të keqtrajtimit, në praktikë është i vakët. Padia civile në procesin penal përdoret shumë rrallë. Faktori kryesor është mendësia sipas së cilës, “nderi nuk mund të blihet me para”, por ka, gjithashtu, edhe një sërë faktorësh të tjerë.
5. Përveç punës që bëjnë disa organizata jofitimprurëse për ndërgjegjësimin dhe gjetjen e rrugëve konkrete për përmirësimin e situatës, duhet që të gjenden mjete efektive në kuadrin e një mekanizmi, për të garantuar që të ruhen dhe zbatohen të drejtat e grave, për të përmirësuar trajtimin dhe pozitën e femrave në familje dhe në shoqërinë shqiptare. Organet që merren me dhënien e drejtësisë duhet të shohin me prioritet rastet kur pjesë e keqtrajtimit dhe e dhunës së ushtruar janë gratë dhe vajzat. Ato shpesh detyrohen të heqin dorë nga akuza për një arsye apo tjetër. Shumë krime të ndodhura ndaj grave vite më parë, janë akoma pa autor.
6. Fuqizimi ekonomik i grave përbën një ndër kushtet themelore për arritjen e barazisë gjinore, reduktimin e dhunës me bazë gjinore.

7. Integrimi gjinor duhet të jetë pjesë e gjithë politikave sociale, ekonomike dhe politike në Shqipëri për të pasur arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm nëpërmjet shfrytëzimit të potencialit të plotë njerëzor të vendit, sikurse dhe garantimit të gëzimit të këtyre arritjeve nga të gjitha grupet shoqërore.
8. Ngritja në të gjithë njësitë e qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të akteve nënligjore (qarqe dhe bashki) e mekanizmave të referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.
9. Ngritja dhe forcimi i mekanizmave për barazinë gjinore në nivel qendror dhe vendor, veçanërisht shpejtimi i procesit për emërimin e nëpunësve gjinorë në strukturat e Ministrive dhe të nëpunësve vendorë për çështjet gjinore në bashkitë e vendit.
10. Dhënia prioritet politikave lidhur me pjesëmarrjen e grave dhe vajzave nga skemat e mbështetjes me të ardhura, në programe aktive punësimi, formimi profesional dhe ritrajnimi.
11. Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 02.12.2010 “Për luftën kundër dhunës ndaj gruas dhe rritjen e dimensionit parlamentar të luftës kundër dhunës në familje”.
12. Ngritja e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe të rehabilitimit për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, nga njësitë e qeverisjes vendore me të ardhurat e tyre.
13. Zbatimi i masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe asaj në Familje 2011-2015, të cilat kërkojnë krijimin e procedurave dhe mundësive për nënkontraktimin e OJF-ve, për të ofruar shërbimet përkatëse për viktimat e kësaj dhune.
14. Ngritja e një Qendre tranzitore nga shteti, për gratë të cilat nuk janë viktime të trafikut dhe as të mbrojtura me një vendim gjykate, por që dhunohen fizikisht dhe psikologjikisht, dhe nuk kanë të ardhura apo mundësira të tjera për tu strehuar apo sistemuar. Shumë gra dhe vajza të kësaj kategorie, paraqiten pranë zyrave të institucionit të Avokatit të Popullit, ku kërkojnë ndihmë për tu strehuar dhe ne i rekomandojmë në OJF të ndryshme pasi shteti nuk disponon një institucion tranzitor për këtë kategori.
15. Plotësimin e ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar) në nenin 32 të tij duke shtuar si dispozitë ligjore në pikën 4 edhe ngacmimin moral të punëmarrësit, nga ana e punëdhënësit, i cili me veprime të përsëritura ka si qëllim shkatërrimin ose degradimin e kushteve të punës, duke i cenuar të drejtat dhe dinjitetin/moralin si dhe duke dëmtuar shëndetin fizik dhe mendor të tij.

16. Situata në Qëndrat e Viktimave të Dhunës: Pas inspektimit në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës, Kamëz, Tiranë, u bënë rekomandimet si më poshtë:

- Shkarkimin nga detyra të drejtueses së Qendrës, duke zgjidhur menjëherë kontratën e punës, për shkaqe të justifikuara në bazë të nenit 153 të Kodit të Punës.
- Marrjen e masave për riorganizimin e stafit dhe shtimin në organikë si shumë të nevojshëm dhe domosdoshëm të një juristi dhe një psikologeje.
- Marrjen e masave për ruajtjen dhe shoqërimin me njerëz të specializuar, me mjetin e institucionit të grave dhe fëmijëve kur ato dalin jashtë Qendrës.
- Trajnimin e vazhdueshëm të stafit në lidhje me trajtimin dhe komunikimin që ato duhet të kenë me gratë dhe fëmijët e strehuar në këtë Qendër.
- Hartimin e një rregullore të brendshme, shumë të nevojshme ku të përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrimet e stafit dhe grave të strehuara, rregulla të cilat të mos bien ndesh me Kushtetutën dhe liritë themelore të njeriut.
- Detyrimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për nxjerrjen e udhëzimit për zbatimin e standarteve sipas VKM nr. 505, datë 13.07.2011.
- Përmirësimin për trajtimin ushqimor konform kuotave me shumëllojshmëri dhe produkteve stinore.

17. Situata në Qendren Pritese të Viktimave të Trafikimit, Linëz, Tiranë: Pas inspektimit në këtë qender, u bënë rekomandimet si më poshtë:

- Marrjen e masave për lëvrin e një buxheti të mjaftueshëm për këtë qendër, lëvrin e fondeve për riparime dhe punime restauruese, me qëllim eliminimin e problematikave ekzistuese në godinat ekzistuese (rikonstruksion, mirëmbajtje dhe restaurime), si dhe ofrimin e kushteve të jetesës për përfituesit konform standarteve të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi.
- Marrjen e masave për lidhjen e një marrëveshje me Drejtorinë Rajonale Arsimore Tiranë, për të mundësuar aksesin për edukim të personave të strehuar pranë kësaj qendre të cilët i përkasin moshës së arsimit të detyruar, me qëllim rikthimin e tyre sa parë në procesin mësimor, ndjekjen e arsimit të detyruar dhe vazhdimin e ciklit përkatës, për të mos humbur vitin shkollor, në përputhje me të drejtën e çdo individi për të përfituar të drejtën e arsimit

falas. Këto masa të shërbejnë edhe për fëmijët e moshës 3-6 vjec që gjenden në qendër.

- Të përcaktohen të drejtat dhe detyrat e këtij institucion shtetëror, shërbimet që duhet të ndërmarrë ky institucion për t'u siguruar një jetë normale viktimave të trafikut, si dhe statusin, të drejtat dhe detyrat që gëzojnë personat e strehuar pranë kësaj qendre, në përputhje me nenin 6 të ligjit nr. 90/2012 datë 27.09.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".
- Marrjen e masave për pajisjen e personave të strehuar me veshmbathjet e munguara (triko, kepuçë, pantollona etj.), për një trajtim human dhe dinjitoz të tyre.
- Marrjen e masave për të shfrytëzuar të gjitha mundësitë për të vënë në funksion këndin e lojrave për të miturit, për të plotësuar nevojën e tyre për argëtim të paktën brenda ambienteve të qendrës, si dhe për rikthimin në gjendje pune të mjeteve kompjuterike, brenda ambienteve të kësaj qendre.

4.5. Fëmijët e pashoqëruar nga prindërit.

*"...fëmija... duhet të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe kuptimi... për zhvillimin e plotë dhe harmonik të personalitetit të tij..."*³⁴

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 54 të saj i ka cilësuar fëmijët si subjekte që kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. Ky përcaktim përbën një bazë të rëndësishme në lidhje me marrjen e masave të duhura e të nevojshme për t'i mbrojtur këta subjekte dhe të drejtat e tyre në çdo situatë e kur është e domosdoshme. Pra, vetë Kushtetuta nëpërmjet kësaj dispozite ka bërë një diferencim mes subjekteve të mitur dhe të rritur, duke ju siguruar një mbrojtje më të mirë për arsye të pamundësisë e vulnerabilitetit të tyre, gjë që ligjvënësi e realizon nëpërmjet cilësimit si "subjekte të mbrojtjes së veçantë". Megjithatë ky parashikim i Kushtetutës është mjaft i përgjithshëm, pavarësisht faktit se ai krijon një bazë të mirë për mbrojtjen e të miturve dhe garantimin e të drejtave të tyre në përgjithësi. Respektimi dhe vlerësimi i dinjitetit të fëmijëve në përgjithësi, veçanërisht i kategorive të fëmijëve jetimë

³⁴ Hyrje e Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

si dhe të fëmijëve që shfrytëzohen për të punuar, janë një sfidë e madhe që lidhet pazgjidhshmërisht me afirmimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore, në një shoqëri që përditë aspiron vendosjen dhe konsolidimin e vlerave demokratike.

Përse në lajmet dhe kronikat e ndryshme në media ndeshemi me raste fëmijësh shqiptarë të gjetur në shtetet fqinje apo më tej, të shfrytëzuar apo të trafikuar?

Fakti i fëmijëve që punojnë apo lypin, i fëmijëve të larguar jashtë Shqipërisë të pashoqëruar nga prindërit, dhe i fëmijëve të braktisur apo të lënë përkohësisht nën kujdestarinë e të afërmeve, kërkon që probleme të tilla duhet të adresohen në mënyrë të shpejtë.

Është e vërtetë që në vitet e tranzicionit në Shqipëri, çështja e trafikimit të fëmijëve shqiptarë, përbente një problem të madh shqetësues. Me të drejtë shqetëson gjithë vendet ballkanike, por në veçanti Greqinë, që është vendi ku një pjesë e madhe e këtyre fëmijëve kanë mbetur, të shtyrë apo jo nga prindërit e tyre, jo vetëm për t'u trafikuar, por dhe për të kryer punë të ndershme, dhe që dashje pa dashje shpesh herë kanë rënë edhe pre e trafikantëve, duke u shfrytëzuar për lypësi, prostitucion dhe për punë të tjera. Mund të themi që ky trafikim ka ardhur në rënie, sepse edhe shteti shqiptar, çdo vit e më tepër po merr masa shumë të rrepta për ta parandaluar trafikimin dhe për të vënë para përgjegjësisë sidomos ata persona që janë implikuar dhe janë zbuluar se kanë organizuar dhe ose marrë pjesë në trafikimin e personave. Avokati i Popullit është i hapur për bashkëpunime të mëtejshme jo vetëm me organizmat shtetërore, por dhe me organizatat jofitimprurëse në mbrojtje e në ndihmë të të drejtave të fëmijëve.

Shoqëria dhe shteti ynë kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim, me garantimin në Kushtetutë të mbrojtjes së veçantë për fëmijët (neni 54); ratifikimin e Konventës së OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës" (viti 1992); ratifikimi i Protokollit opsional të Konventës së OKB-së "Për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë"³⁵ dhe veç të tjerave ka marrë përsipër në këtë mënyrë të ushtrijë përgjegjësitë e tij lidhur me mbrojtjen e sigurimin e jetës së fëmijëve, si dhe eliminimin e formave më të egra të shfrytëzimit ndaj tyre. Miratimin e ligjit nr. 10347, datë 04.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës"; krijimin e mekanizmave institucionale për mbrojtjen e këtyre të drejtave në nivel qendror dhe vendor; miratimin e planit të veprimit për fëmijët 2012-2015 (VKM nr. 182, datë

³⁵ Ligji nr. 9834, datë 22.11.2007.

13.03.2012); përcaktimin e qartë të parimeve që mbrojnë fëmijët dhe të drejtat e tyre në Kodin e Familjes; miratimin dhe plotësimin e nevojshëm të bazës ligjore për ndalimin e dhunës në familje; parashikimin dhe zgjerimin e gamës së veprave penale që parandalojnë abuzimin me fëmijët, në Kodin Penal, etj.

Miratimi i ligjit nr. 10347, datë 04.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” konsiderohet dhe përbën një hap përpara në institucionalizimin e të drejtave të fëmijës në vendin tonë, pasi ka parashikuar ndër të tjera mekanizmat institucionale për mbrojtjen e këtyre të drejtave në nivel qendror dhe vendor. Megjithëse ka një numër aktorësh të qeverisjes qendrore e asaj vendore, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre këtë kategori sociale, bashkëpunimi ndërmjet tyre mbart probleme të koordinimit, kompetencave dhe shkëmbimit të informacionit. Gjithashtu, shpërndarja e burimeve financiare në mbështetje të të rinjve me shërbime, është e pamjaftueshme dhe nuk sjell ndryshime të qenësishme në pavarësimin e tyre.

“Kudri ligjor për të drejtat ekonomike dhe sociale është përmirësuar, por zbatimi tij është i ngadalshëm, veçanërisht në lidhje me njerëzit me aftësi të kufizuara dhe fëmijët në rrezik të abuzimit”³⁶. Po kështu ekziston një Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve që janë viktima të trafikimit.³⁷

“Në fushën e të drejtave të fëmijëve, me ndryshimet e vitit 2013 të Kodit Penal mbajtja e materialeve pornografike me fëmijë dhe lehtësimi i trafikimit të tyre janë cilësuar si vepra penale. Në bashki dhe komuna janë 173 njësi të mbrojtjes së fëmijëve (NjMF). Numri i NjMF-ve duhet të rritet ndjeshëm me qëllim që të garantohet mbrojtje e qenësishme e fëmijëve dhe e fëmijëve vulnerabël. Kapacitetet e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve duhet të forcohen. Sistemit të mbrojtjes së fëmijës i mungon buxheti i mjaftueshëm, qëndrueshmëria e stafit dhe standardet bazë të punës, sidomos protokollat dhe kërkesat ligjore. Emigrimi i të miturve të pashoqëruar, kryesisht romë, nga Shqipëria drejt BE-së vazhdon të jetë sfidë. Në lidhje me punën e fëmijëve, mbetet shumë i lartë numri i fëmijëve (kryesisht romë) që punojnë ose lypin në rrugë dhe janë objekt i formave më të këqija të shfrytëzimit dhe marginalizimit ekstrem. Shteti nuk ka marrë asnjë masë efektive për të adresuar punën dhe shfrytëzimin e fëmijëve. Nevojitet një sistem mbrojtje për fëmijët që ofron

³⁶ Faqe 13 e Progres Raportit të BE për Shqipërinë, 2013

³⁷ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9544, datë 29.05.2006

shërbime mbështetëse të specializuara për fëmijët në rrezik abuzimi apo shfrytëzimi, duke mbështetur më fuqishëm familjet në vështirësi dhe shërbimet me bazë komuniteti. Nuk janë marrë masa adekuate që fëmijët e abuzuar seksualisht të kenë shërbime të specializuara.”³⁸.

Avokati i Popullit ka synuar të japë një kontribut të veçantë në luftën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si me anë të trajtimit të ankesave individuale apo të hetimit me iniciativën e tij të rasteve të bëra publike, ashtu edhe me anë të shqyrtimit të legjislacionit dhe rekomandimeve për ndryshime apo përmirësime të nevojshme të tij.

Në këtë kontekst kujtojmë se Avokati i Popullit, pasi mori njoftim nga një gazetë shqiptare, ka ndjekur me përparësi rastin me natyrë tepër komplekse dhe ndërkombëtare, të “zhdukjes” se rreth 500 fëmijëve shqiptarë nga një institucion i kujdesit të fëmijëve në Greqi. Hetimet e Ombudsmanit Grek të zhvilluara me kërkesën tonë konfirmuan se, në të vërtetë, një numër i madh fëmijësh, kishin ikur apo ishin marrë nga institucioni kujdestar “Agia Varvara” në Athinë ku ata ishin vendosur gjatë periudhës 1998-2002. Zyrtarisht ata konsiderohen të “zhdukur” sepse atyre në vitin 2002 nuk i dihej vendndodhja nga policia ose autoritete të tjera, në një kohë që mund të ishin në duar të trafikantëve etj. Zyra e Ombudsmanit Grek na dërgoi një raport të hollësishëm në lidhje me Agia Varvarën. Rezultoi që në vitin 1998-2002 në këtë qendër janë strehuar rreth 640 fëmijë, por që faktikisht këto fëmijë, mbasi janë strehuar në Agi Varvara, përsëri janë larguar në pjesën më të madhe dhe nuk dihet në ç’ drejtim kanë vajtur dhe në dorë përsëri të kujt kanë rënë. Rezulton që pjesa më e madhe e atyre fëmijëve janë larguar dhe nuk ka evidenca të sakta se në dorë të kujt kanë rënë. Pra qëllimi i mirë i autoriteteve përgjegjëse greke nuk u justifikua me masat e marra dhe me rezultatin që realisht është konstatuar nga ana e zyrës së Ombudsmanit Grek.

Duke u nisur nga problematika e hasur lidhur me fëmijët shqiptarë të trafikuar në Greqi nga palë të treta apo edhe vetë familjarët, Qeveritë e të dy vendeve firmosën në vitin 2006 një marrëveshje për të rregulluar çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët viktime trafikimit, që gjenden në Greqi, për të cilët, duke pasur parasysh interesin më të lartë të fëmijës, ose do të ktheheshin vullnetarisht në mënyrë të asistuar, ose të integroheshin në këtë vend destinacioni. Kjo marrëveshje është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9544, datë 29.05.2006.

³⁸ Faqe 52 e 53 e Progres Raportit të BE për Shqipërinë 2013.

E drejta e fëmijës për të mbajtur rregullisht marrëdhënie dhe takime të drejtpërdrejta me të dy prindërit, reflektohet në nenin 18 të Konventës si dhe në nenin 215 të Kodit të Familjes, sipas të cilit të dy prindërit kanë përgjegjësi të përbashkët për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës. Gjithsesi, ka mjaft raste ku zbatimi në praktikë i vendimeve gjyqësore le për të dëshiruar, sidomos kur mungon vullneti i njërit prind për ta zbatuar atë.

Në realitet ka mjaft fëmijë që jetojnë në një gjendje të vështirë ekonomike dhe me të ardhura të pakëta. Skema e sigurimeve shoqërore, por edhe asistenca që ofron shteti për familjet e varfra, nuk siguron shpeshherë as minimumin jetik për këto familje dhe për pasojë, as për fëmijët e tyre. Kjo gjë ka çuar shpeshherë në punësimin e fëmijëve në kundërshtim me ligjin, që i çon ata në trauma dhe në gjendje psikologjike të vështira.

Pavarësisht nga vëmendja në rritje në mbrojtje të të drejtave të fëmijës, mungesa e kujdesit lidhur me të drejtën e privatësisë së fëmijës janë karakteristikat kryesore të lajmeve që shpesh raportohen në Shqipëri për veprat penale ndaj të miturve. Rastet e njerëzve të humbur dhe të fëmijëve të humbur mbeten ende një problem për shoqërinë shqiptare. Në këtë fushë ka disa emisione televizive që trajtojnë rastet e fëmijëve të humbur dhe fatin e tyre. Janë pikërisht këto histori që dalin në faqet e gazetave, që është në fakt domethënëse për mekanizmin përzgjedhës të temave që prekin fëmijët dhe që duhet të pasqyrohen në këto gazeta. Në përgjithësi nuk mund të arrihet në përfundimin që pasqyrimi i fëmijëve në gazetë e përditshme është tërësisht serioz, i thelluar dhe etik. Përpjekjet për të pasqyruar fëmijët dhe për tu dhënë atyre një zë të vërtetë si dhe vendin që meritojnë janë mjaft të kufizuara, për arsye të ndryshme. Përveç kësaj, edhe atëherë kur fëmijët dalin në faqet e gazetave, pasqyrimi i tyre shpesh ngre pikëpyetje të rëndësishme etike në lidhje me temat që mbulojnë, identifikim e të miturve, mënyrën e intervistimit, si dhe rrethana të tjera që gazetarët duhet të kenë parasysh kur trajtojnë të miturit. Në përgjithësi mund të thuhet se pasqyrimi mbizotërues është ai sensacional, dhe i pamjaftueshëm dhe jo ai korrekt dhe pa stereotipa për fëmijët. Shpesh në raste të trafikimit, mediat kanë dhënë identitetin e viktimave të mitur. Respektimi i Kodit të Transmetimit të miratuar së fundmi nga Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe vendosja e sanksioneve për mediat-operatorët televizivë që shkelin të drejtat e fëmijëve, përbën një sfidë, që do t'i shërbejë edhe punës parandaluese.

MPÇSSHB së bashku me Ministrinë e Brendshme, bazuar në VKM nr. 265, datë 12.04.2012 “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore, përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrës së procedimit”, ka nxjerrë për zbatim Urdhrin e përbashkët nr. 125, datë 23.08.2012

“Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të cilët janë të ekspozuar ndaj formave të abuzimit ndaj tyre”, sipas të cilit çdo fëmijë i ndodhur në situatë emergjente, do të merret në mbrojtje të menjëhershme nga strukturat e Policisë së Shtetit në bashkëpunim me strukturat e SHSSH. Konform këtij urdhri të gjitha rastet emergjente të fëmijëve në rrezik të identifikuar nga policia e shtetit së bashku me punonjësit socialë të Zyrave rajonale të shërbimeve sociale dhe SHSSH, do të referohen në njësitë për të drejtat e fëmijëve në nivel qarku, bashkie e komune. Fëmijët parashikohet të qëndrojnë në institucionet rezidenciale publike e jopublike të përkujdesit social deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga organet e drejtësisë³⁹. Por përderisa shohim rrugëve të Tiranës fëmijë (në shumicë janë romë) që lypin, situata nuk duket aspak e përmirësuar nga zbatimi i këtij Urdhri.

Megjithëse ka një numër aktorësh të qeverisjes qendrore e asaj vendore, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre këtë kategori sociale, bashkëpunimi ndërmjet tyre mbart probleme të koordinimit, kompetencave dhe shkëmbimit të informacionit.⁴⁰

Puna e fëmijëve në përgjithësi dhe fëmijët të rrugës në veçanti, si forma të shfrytëzimit ekonomik dhe punës së detyruar të fëmijëve në Shqipëri, përbëjnë një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Shkaqet e punës së rëndë të fëmijëve duhen kërkuar tek përjashtimi social, mundësitë e pakta të familjeve për të siguruar të ardhura, si dhe varfëria. Për aq kohë sa nuk punohet për zhdukjen e shkaqeve, shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve do të përbëjë një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

Edhe në raportin e Departamentit të Shtetit Amerikan, qershor 2013, forcohet fakti që Shqipëria mbetet akoma një vend origjine për trafikimin, ku përpos burrave dhe grave listohen dhe fëmijët subjekt i trafikimit seksual, punës së detyruar duke përfshirë këtu dhe lypjen e detyruar.

³⁹ Shih nenin 39 të ligjit nr. 10347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” që përcakton se: “Neni 39 Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki/komunë 1. Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki/komunë funksionon brenda strukturës administrative të bashkisë/komunës, si njësi e posaçme ose si njësi e strukturave të ngarkuara me çështje sociale dhe ka për detyrë: a) të vlerësojë dhe të monitorojë në vazhdimësi situatën e familjeve të fëmijëve në rrezik, derisa fëmija të konsiderohet “jo në rrezik”; b) të bëjë identifikimin dhe të bashkërendojë, në mënyrë multidisiplinare, mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve në territorin e bashkisë/komunës; 2. Pranë bashkisë/komunës krijohen grupet multidisiplinare për mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve të fëmijëve në rrezik në territorin e bashkisë/komunës”.

⁴⁰ Marrë nga Raporti i veçantë i Avokatit të Popullit (viti 2012) “Për të drejtat e fëmijëve jetimë, përfshirë këtu fëmijët e sistemuar në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore, si dhe të fëmijëve që shfrytëzohen për të punuar”.

Ekziston perceptimi i moszbatimit të përcaktimeve ligjore që parashikojnë masa shtrënguese për prindërit që braktisin fëmijët, që nuk i dërgojnë në shkollë, apo dhe ata që i detyrojnë fëmijët të punojnë.⁴¹

Fakt është se, numri i rasteve të dhunës në familje të evidentuara dhe trajtuara nga ana e strukturave të policisë së shtetit, ka ardhur në rritje. Veçanërisht për rastet e fëmijëve të dëmtuar nga ushtrimi i dhunës në familje, sipas statistikave zyrtare të Ministrisë së Brendshme, evidentohet se numri i trajtuar dhe marrë në mbrojtje nga Policia e Shtetit gjatë viteve të fundit tregon për impenjim dhe angazhim në këtë fushë.⁴²

Grup mosha e fëmijëve përfitues të të gjithë shërbimeve rezidenciale të ofruara është 0-16 vjeç, (sipas VKM nr. 425, datë 27.06.2012). Mbi moshën 16 vjeç shërbimet mbështetëse për këta fëmijë janë të pakta dhe ato jepen kryesisht nga OJF-të që, mbështesin këtë grup moshe me programe integruese në komunitet, nëpërmjet nxitjes së jetesës së pavarur.⁴³

Sipas Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit “Mbi trafikimin e qenieve njerëzore”⁴⁴ të datës 19 Qershor 2013, Shqipëria është kryesisht vend burimi për burra, gra dhe fëmijë që bëhen pre e trafikimit për qëllime të shfrytëzimit seksual dhe për punë të detyruar, përfshirë edhe lypjen me detyrim për fëmijët. Ka akoma gra dhe fëmijë shqiptarë që janë objekt trafikimi me qëllim shfrytëzimin seksual brenda vendit. Viktimat shqiptare u nënshtrohen kushteve të punës së detyruar dhe trafikimit me qëllim shfrytëzimin seksual në Greqi, Itali, Maqedoni, Kosovë, Serbi dhe në gjithë Evropën Perëndimore. Fëmijët shfrytëzoheshin për qëllime seksuale, lypje me forcë dhe akte kriminale të detyruara, si për shembull grabitje dhe shpërndarje droge. Vajzat gjithashtu kanë qenë objekt prostitucioni apo pune të detyruar pas

⁴¹ Neni 40 i ligjit “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” përcakton se: “1. Shkeljet e të drejtave të parashikuara në nenet 7, 8, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 21 dhe 26 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, përkatësisht: a) personi fizik, nga 30,000 deri në 60,000 lekë; b) personi juridik nga 60,000 deri në 120,000 lekë; c) personi fizik brenda personit juridik, i cili është përgjegjës për shkelje, nga 30,000 deri në 80,000 lekë; ç) personi, i cili ushtron funksion publik, nga 30,000 deri në 80,000 lekë.2. Procedura për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative dhe ekzekutimin e gjobave, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, bëhet në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

⁴² Sipas informacionit të dhënë në shkresën nr. 7782/4, datë 30.01.2013 të Ministrisë së Brendshme, numri i rasteve të dhunës në familje të evidentuara dhe trajtuara nga Policia e Shtetit, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, rezulton përkatësisht sipas viteve: 2008-822 raste; 2009-1217 raste; 2010-1998 raste; 2011-2181 raste dhe 2012-1860 raste. Lidhur me rastet e dhunës në familje ndaj fëmijëve rezultojnë: 2008-77 raste; 2009-49 raste, 2010-120 raste; 2011-98 raste; 2012-46 raste.

⁴³ Ibid.

⁴⁴ Të datës 20 qershor 2012.

martesave me mblesëri. Qeveria shqiptare, thuhet në raport, nuk i përmbush kushtet minimale për eliminimin e trafikimit; me gjithë masat e konsiderueshme që ka marrë për të luftuar këtë dukuri. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, qeveria nuk mundi të paraqiste prova për shtimin e përpjekjeve në shqyrtimin e trafikimit të qenieve njerëzore gjatë periudhës që mbulon raportin dhe për këtë arsye Shqipëria vendoset në Listën e Vëzhgimit ‘Grupi 2’. Në raport, qeveria shqiptare kritikohet se hoqi koordinatorin kombëtar kundër trafikimit, i cili ishte shumë efikas në bashkëpunimin me OJQ-të për të zhvilluar mekanizmin kombëtar të referimit (MKR) dhe procedurat standarde të veprimit, dhe e la këtë pozicion bosh për pesë muaj. Kjo bëri që zyra e koordinatorit kombëtar të mos kishte autoritetin të organizonte takime ndërmjet agjencive. Ndihma për fëmijët viktimë të trafikimit nuk ishte e vazhdueshme”.

Rekomandimet për Shqipërinë: “Të zbatohet paraprakisht procedurat e reja standarde për identifikimin e viktimave me qëllim rritjen e gamës së viktimave të identifikuar në Shqipëri; të sigurojë fonde të mjaftueshme për OJQ-të që japin ndihmë jetike për viktimat; të sigurojë qasje me viktimën në fokus me qëllim identifikimin e viktimave duke mos vënë si kusht për të siguruar statusin e viktimës rolin e tyre në hetimet penale; të zgjerojë fokusin e kujdesit për të siguruar më shumë shërbime për komunitetin gjatë ri integritit të viktimave dhe për të fuqizuar të mbijetuarit, të ndihmojë në zbutjen e përbuzjes që lidhet me trafikimin; të vazhdojë të marrë masa për rritjen e mbrojtjes së dëshmitarit-viktimë për viktimat që janë gati të bashkëpunojnë në zbatimin e ligjit; të ndjekë më fuqishëm rastet e trafikimit që ndodhin brenda vendit; dhe të hetojë paraprakisht bashkëpunimin e zyrtarëve qeveritarë në lidhje me trafikimin”⁴⁵.

Duke patur parasysh që fëmijët e paregjistruar në gjendjen civile janë një nga kategoritë më të ekspozuara ndaj abuzimeve apo krimeve të ndryshme, si dhe duke u bazuar në vështirësitë e hasura në praktikë për regjistrimin e tyre në Gjendjen Civile, është miratuar Udhëzimi nr. 07 Prot, datë 10.01.2012 “Për miratimin e procedurës dhe të procesverbaleve që do të plotësohen nga përfaqësues të Policisë së Shtetit dhe të Bashkive/Njësive Bashkiake/Komunave, për rastet e fëmijëve të gjetur dhe të fëmijëve të paregjistruar në Gjendjen Civile”. Ndonëse me ritme më të ulta ende problemi i fëmijëve të paregjistruar mbetet dhe prek kryesisht fëmijët rom. Sipas studimit të UNICEF dhe Qendrës

⁴⁵ Po sipas raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit të vitit 2012 për Shqipërinë.

për Studime Ekonomike dhe Sociale “Hartëzimi i fëmijëve romë” nëntor 2011, vlerësohet se janë rreth 359 fëmijë romë të peregjistruar në vend.

Fëmijët, shpesh janë kthyer në një burim fitimi me një kosto të ulët. Dhe kjo në disa forma si shfrytëzimi seksual i të miturve dhe prostitucioni. Po kështu shfrytëzimi në punë i të miturve mbetet një plagë e rëndë. Nevoja për të mbijetuar e të miturve dhe fëmijëve të tjerë të shtyrë për të pranuar të gjithë mundësitë për punë, shkon në dëm të të drejtave elementare të edukimit dhe shëndetit. Duke patur parasysh interesat e fëmijëve për këto raste duhet të procedohet me dorën e hekurt të ligjit dhe të të gjithë strukturave ligjore si polici, prokurori, etj. deri sa të jepen shembuj konkret se si realisht shteti shqiptar zbaton çka ka ratifikuar dhe çka ka sanksionuar në aktet ligjore dhe nënligjore.

Nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet ligjore që parashikojnë sanksione për prindërit që braktisin fëmijët, që nuk i dërgojnë ata në shkollë apo edhe ata që i detyrojnë fëmijët të punojnë.

Në konkluzionet e rrjetit të Ombudsmanëve të Evropës Jugore dhe Lindore ”Mbi fëmijët në lëvizje”⁴⁶ është përkufizuar që: “Fëmijë në lëvizje dhe fëmijët në rrezik të lartë të trafikimit janë një grup veçanërisht vulnerabël, pavarësisht nëse janë të shoqëruar nga prindërit e tyre apo kur udhëtojnë vetëm në kërkim të kushteve më të mira, për t’i shpëtuar dhunës, abuzimit, varfërisë, luftës, fatkeqësive natyrore apo përpjekjeve që i detyrojnë për tu larguar nga vendbanimi i tyre”.

Avokati i Popullit, përmes rekomandimeve të tij, mundohet të edukojë Administratën, duke e bërë atë të kuptojë rolin e saj të vërtetë ndaj qytetarëve, pra të kuptojë se arsyeja e vërtetë e ekzistencës së saj është shërbimi ndaj qytetarëve që të realizojnë të drejtat e tyre. Kjo do të vijojë edhe me përfundimin e këtij raporti, me adresimin e rekomandimeve konkrete drejtuar Institucioneve qendrore me udhërrëfyes interesin më të lartë të fëmijës.

Disa rekomandime

- Nga shteti ynë duhen saktësuar shifrat e sakta të azilkërkuesve shqiptarë në vende të ndryshme të BE.

⁴⁶ Të zhvilluar në Zagreb (Kroaci), 5 nëntor 2013.

- Vëmendje e posaçme i duhet kushtuar të ngjuarve për gjakmarrje, si dhe për të konkluduar nëse personat që kanë kryer krimin janë hetuar e ndëshkuar nga drejtësia. Vetëm garantimi i vendosjes së drejtësisë, ndëshkimi i autorëve të vrasjeve, mbrojtja dhe përfaqësimi i rregullt i viktimave gjatë gjykimeve, si dhe dëmshpërblimi i dëmit të shkaktuar, do të çojnë në shmangien e ngujimit. Po kështu pasja e statistikave të sakta nga shteti ynë lidhur me familjet e ngjuara, do të krijojë mundësimin e përballjes me përfaqësuesit e vendeve anëtare, e do të ndërgjegjësojë opinionin për pasojat e kërkesave për azil me dokumentacion fals.
- Kategoritë e rrezikuara të fëmijëve janë fëmijët që lypin, që braktisin shkollën, ndaj këta fëmijë duhet të referohen, asistohen dhe trajtohen nga njësitë për mbrojtjen e fëmijëve në çdo bashki e komunë, struktura të cilat në zbatim të detyrimit ligjor duhen ngritur në të gjitha njësitë vendore.
- Këshillimi dhe paditja e rasteve flagrante kur prindërit dërgojnë të vegjlit të lypin duhet intensifikuar nga ana e sektorit për të miturit dhe dhunës në të gjitha drejtoritë e policisë. Zbatim të ligjeve kundër punës së fëmijëve, dhunës ndaj fëmijëve, ligjeve për arsimin e detyrueshëm, si dhe të ligjeve që në mënyrë indirekte synojnë dënimin e individëve abuzues me fëmijët; financim për shërbime mbrojtëse për viktimat fëmijë të trafikimit. Nevojitet gjithashtu, krijimi i kapaciteteve dhe mundësive financiare të mjaftueshme në qeverisjen vendore, për ngritjen e strukturave të reja në përputhje me nevojat e fëmijëve, trajnim i vazhdueshëm i stafëve respektive, si dhe një koordinim më i mirë mes këtij pushteti, dhe aktorëve të tjerë të kësaj fushe.
- Nevojitet një performancë më cilësore dhe profesionale nga gjyqësori, në lidhje me çështjet në të cilat duhet vënë në qendër interesi më i lartë i fëmijës. Ky parim duhet të gjejë shprehje jo vetëm si frazeologji në vendimet gjyqësore, por është e nevojshme të theksohet se ai duhet të jetë konsideratë parësore në veprimtarinë e tyre. Në këtë kontekst, respektimi i mendimit të fëmijës, garantimi i alternativës më të mirë të mirërritjes dhe mirëqenies për të, si dhe e mosdiskriminimit, duhet të jenë qartësisht të shqyrtuara dhe të pasqyruara në vendimet gjyqësore.
- Çështjes së fëmijëve të zhdukur nuk duhet t'i kushtohet rëndësi vetëm në ditën përkatëse ndërkombëtare (pra datën 25 maj), por duhet të jetë në prioritet të punës së gjitha organeve të drejtësisë.
- Sfidë përbën jo vetëm për shtetet pritëse, por edhe për Shqipërinë, dekurajimi i migracionit të paligjshëm, kthimi i personave qofshin edhe të mitur bazuar në

procedura të paracaktuara si dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të tyre, duke zbatuar jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila sanksionon mbrojtjen e posaçme në rastet e kthimeve, dëbimeve, ekstradimeve. Garantimi i interesit më të lartë të fëmijës përbën objektiv primar të çdo Shteti, bazuar dhe në përcaktimet e Konventës së OKB “Për të drejtat e fëmijës”, e cila është ratifikuar nga të gjitha shtetet Evropiane⁴⁷.

- Duhet forcuar burimet teknike dhe financiare të Policisë Kufitare dhe Migracionit, për të eliminuar mundësinë e kalimit të paligjshëm të kufirit nga të miturit.
- Ndërgjegjësim më i madh lidhur me ekzistencën e Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashkitë dhe Komunitetet e vendit, aty ku ato janë ngritur, lidhur me ndihmën që kanë për detyrë t’i sigurojnë fëmijëve të keqtrajtuar, abuzuar etj.

Tashmë nga Shqipëria kërkohet: Ndërtimi i një sistemi multi-sektorial eficient për mbrojtjen e fëmijëve me qëllim parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe integrimin e fëmijëve viktime nga çdo lloj forme të dhunës dhe të përcaktojë procedura dhe mekanizma për identifikimin, raportimin, referimin, investigimin, trajtimin dhe koordinimin e rasteve të fëmijëve viktime të dhunës dhe ofrimin për fëmijët të një informacioni konkret se si ata të kërkojnë ndihmë⁴⁸.

Komiteti i të Drejtave të Fëmijës ka përcaktuar se: “Në rastet kur fëmijët janë përfshirë në procedura të kërkimit të azilit apo në procedime gjyqësore ose administrative, përveç caktimit të një kujdestari, duhet tu sigurohet edhe asistencë ligjore”.⁴⁹

Së fundmi vendosja e garantimit të shtetit të së drejtës përbën një garanci për të evituar e shmangur lëvizjen e parregullt të shtetasve drejt vendeve të BE për një jetë më të mirë.

4.6. Shërbimi shëndetësor.

Sipas analizimit të shkaqeve që kanë ndikuar në rritjen e kërkesave për azil të shtetasve shqiptar, na rezulton se një ndër motivet që paraqesin shtetasit shqiptarë në kërkesën e tyre për azil në vendet e BE është ai i shërbimit shëndetësor. Nga ekzaminimi i dokumentacionit të kërkesave për azil në vendet e BE-së, sipas EASO rezulton se (5-30%) të kërkesave të

⁴⁷ Shih Deklaratën e Rrjetit Evropian të Ombudsmanëve të Fëmijëve “Fëmijët në lëvizje”, e miratuar në mbledhjen e 17 të Asamblesë së Përgjithshme, me 27 shtator 2013 në Bruksel.

⁴⁸ Pika 44/b, c të Rekomandimeve Përfundimtare të Komitetit për të drejtat e fëmijës, mbi raportin e 2-4 të Shqipërisë për Konventën e të Drejtave të Fëmijës, Gjenevë, tetor 2012.

⁴⁹ Komentit nr. 6 I UN Committee on CRC “Mbi trajtimin e fëmijëve të pashoqëruar apo të ndarë, jashtë vendit të tyre të origjinës”-CRC/GC/2005/6, 1 shtator 2005, faqe 6.

shtetasve Shqiptare për azil në vende si Luksemburgu, Suedia apo Danimarka është për shkak të mungesës së shërbimit, cilësisë dhe kushteve të ofrimit të këtij shërbimi në vendin e origjinës. Në raportin e Organizatës së Mësipërme Gjendja e shërbimit shëndetësor në Shqipëri përshkruhet si vijon:

“Shërbimi shëndetësor është i ofruar pa pagesë nga një rrjet i gjërë qendrash të shërbimit shëndetësor parësor, klinika dhe spitale në 36 rajone të vendit. Megjithatë ky sistem nuk ofron një shërbim të specializuar shëndetësor jashtë kryeqytetit të Tiranës. Shërbimet e urgjencës dhe trajtimet e aksidenteve janë të varfra në të gjithë territorin. Korrupsioni në shërbimin shëndetësor mbetet një fenomen shumë i përhapur. Ky fenomen nxit ofrimin e shërbimeve dhe përshpejton procedurat burokratike në ofrimin e shërbimeve shëndetësore”.

Një pjesë e konsiderueshme e shtetasve shqiptarë që kërkojnë azil shëndetësor në vendet e BE-së është bazuar në mos ofrimin e shërbimit shëndetësor dhe mungesës së trajtimit me medikamente të cilësuar të problemeve të shëndetit mendor.

Ajo çka sot shihet me mjaft shqetësim në Evropë, e cila duhet të na shqetësojë edhe ne, është fakti se tranzicioni i zgjatur i shumë vendeve, veçanërisht të Ballkanit Perëndimor ka patur ndikim negativ, duke rritur numrin e njerëzve të prekur me probleme mendore. Përqindja e njerëzve me skizofreni që nuk trajtohen me mjekim është rritur nga 36% në 45%. Sipas raporteve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë OBSH, 47% e personave që vuajnë nga depresioni nuk marrin kurim për shkak të mungesës së një sistemi efikas shëndetësor, mos diagnostikimit apo të problemeve që kanë me mentalitetin e tyre. Kjo ka qenë një nga shkaqet e rritjes së numrit të azilkërkuesve Shqiptarë në BE, të cilët synojnë një trajtim adekuat të problemeve të shëndetit mendor. Adresimi i këtyre problemeve nga autoritetet shtetërore duhet të përbëjë prioritet, sepse situata e konstatuar në këtë shërbim shëndetësor dhe niveli i reagimit të administratës publike shqiptare ndaj tij nuk janë në standardet e kërkuara.

Nga të dhënat dhe gjendja e konstatuar në spitalet psikiatrike të inspektuara, rezulton se kushtet dhe trajtimi i të sëmurëve jo vetëm që linin shumë për të dëshiruar dhe nuk premtinin përmirësimin e shëndetit të tyre, por në shume raste ai ndikonte në përkeqësimin e tij.

Ligji nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, vazhdon të mbetet një akt i pazbatueshëm në shumë dispozita të tij nga personeli mjekësor. Krahas trajnimit dhe direktivave të vazhdueshme që Ministria e Shëndetësisë duhet të jepte për zbatimin e tij, detyrë e rëndësishme mbetet ndryshimi, amendimi dhe nxjerrja e akteve të reja nënligjore për implementimin e tij praktik.

Një mungesë në kuadër të akteve nënligjore mbetet rregullorja e re për kushtet e trajtimit të të sëmurëve mendorë, ku të parashikohen normativat e reja të sipërfaqeve për metër katror të hospitalimit të tyre, dushe dhe tualete për frymë, raport mjek/infermier/kujdestar-pacient etj., cilësia dhe sasia kalorike e ushqimit, norma të reja për veshje dhe shtroje, përlllogaritje e re e kostos së të sëmurit, diferencimi i shpenzimeve për nevojat e pacienteve femra etj.

Në përfundim të prezantimit të një sërë çështjesh që shqetësojnë sot shërbimin shëndetësor në vendin tonë të cilat përbëjnë dhe arsyet e kërkesës së azilit mjekësor të shtetasve Shqiptarë në BE, Avokati i Popullit ndjen nevojën të parashtojë në këtë pjesë të Raportit disa përfundime dhe rekomandime, të cilat shpresojmë që do t'i shërbejnë autoriteteve Shqiptare në reagimet e tyre për përmirësimin e një sërë aspektesh të kësaj fushe ndër të tjera dhe për të kufizuar arsyet e shtetasve shqiptarë për të kërkuar azil shëndetësor në vendet e BE-së.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka arritur në këto përfundime:

1. Gjendja e trajtimit të të sëmurëve mendorë në vendin tonë vijon të mbetet problematike dhe ka tendencë të rrisë shkallën e cenimit të të drejtave dhe interesave të ligjshme të pacientëve.
2. Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e tjera shtetërore kompetente që ofrojnë asistencën e tyre në shëndetin mendor të marrin në konsideratë serioze çështjet që shqetësojnë këtë kategori personash, duke i dhënë një imazh të ri këtij shërbimi.
3. Organet shtetërore duhet të trajtojnë me interesim të veçantë çështjet ligjore dhe nënligjore që kanë nevojë për ndryshim apo miratim, me qëllimin për të përmirësuar aspekte mjaft të rëndësishme të shëndetit publik.
4. Të merren masa për të formësuar një mentalitet të ri në administratën shtetërore që të evidentojë rëndësinë e duhur ndaj shtetasve në nevojë dhe veçanërisht ndaj të sëmurëve.
5. Shërbimi shëndetësor tu përgjigjet standardeve të kërkuara ndaj personave me sëmundje mendore dhe të hartojë strategji për të ofruar mjekë të rinj në këtë shërbim, për t'ju krijuar atyre dhe stafëve mbështetëse lehtësitë e nevojshme.